


E
930
T 90
GJIROKASTËR

SHËTIT

TRADITA
NDERTIMORE
NE SHQIPERI

930
TPO

TRADITA NDËRTIMORE NË SHQIPËRI



Përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës

Redaktor *Jani Toçka*

ZHVILLIMI URBANISTIK I QYTETIT TË BERATIT

Berati është një nga qendrat e lashta të vendit tonë, me një histori që nis larg, që prej shekullit IV para erës së re. Ai, që prej themeimit të tij si vendbanim i fortifikuar i fisit ilir të desaretëve, ka pasur një jetë thuasë të pandërprerë në kohë, me ngritje dhe ulje të kush-tëzuara nga zhvillimi ekonomiko-shoqëror dhe me ngjarje të rëndësishme për historinë e qytetit.

Zhvillimi urbanistik i Beratit mund të ndiqet pak a shumë mirë për sa i përket qytetit të hapur, i cili zhvillohet jashtë mureve rrethuese të kalasë, ndërsa formulimi urbanistik i lagjes së banuar brenda kalasë në gjendjen e sotme, është një arritje relativisht e vonë, që i përket shekujve XVIII-XIX.

Qyteti i Beratit bën pjesë në grupin e madh të qendrave të banuara qytetare, zanafilla e të cilave ka qenë kalaja. Brenda mureve rrethuese të saj shtrihej dhe qendra e banuar e Beratit. Për karakterin urbanistik të Beratit brenda fortifikimit nuk kemi ende të dhëna që të krijojnë një kuadër pak a shumë të plotë. Me rëndësi është fakti se brenda kalasë, në pjesën më të lartë të saj, ngrihej akropoli, një qendër e fortifikuar, e cila kryente funksionin e vendqëndrimit të sundimtarit dhe njëkohësisht ishte pika e fundit e qëndresës në rast sulmesh. Zhvillimi i qytetit brenda mureve rrethuese natyrisht kishte një kufi. Rritja e qytetit, marrëdhëniet më të ngushta ekonomike me fshatin, fuqizimi i shtresës së zejtarëve etj, ishin shkaqet kryesore të dukurisë së rëndësishme të fillimit të zgjerimit të qytetit dhe



Fig. 1 - Pamje e një rrugice karakteristike në Berat

jashtë qendrës së banuar brenda fortifikimit. Lindin kështu lagjet e para jashtë kalasë, apo Varoshi, siç quheshin në të kaluarën. Të dhënat lidhur me lagjet e para jashtë kalasë në qytetin e Beratit janë të pakta. Një lagje e tillë përmendet për Beratin që në vitin 1280, pra mund të mendohet se fillimi i daljes së qendrës së ba-

nuar i përket fillimit të shekullit XIII dhe mbase është më i hershëm. Të dhëna jo të plota tregojnë se lagjja e parë e banuar, jashtë mureve rrethuese ka qenë në perëndim të kalasë. Gjithashtu, burimet për Beratin tregojnë se deri në mesin e shekullit XV, lagjet e jashtme kanë qenë edhe ato të fortifikuara. Lagjja «Mangalem» ka mundësi të ketë filluar të krijohet si qendër e banuar që në shekujt XIV-XV, ndërsa më pas ndërtimet janë shtrirë në zonën lindore. Ndërtimet e kultit mysliman, si Xhamia Mbret e fundit të shekullit XV dhe Xhamia e Plumbit e vitit 1553, tregojnë se në këtë zonë po formohej qendra e qytetit, pranë të cilit kishte lindur edhe qendra zejtaro-tregtare, e cila grumbullonte krejt veprimtarinë prodhuese të Beratit. Mesi i shekullit XVII e gjen Beratin një qendër mjaft të zhvilluar, ku qyteti i hapur kishte pësuar një rritje të konsiderueshme. Në qendër të qytetit ishte ansambli ndërtimor i pazarit me një shtrirje relativisht të gjatë dhe lagjet e banuara, që tashmë përveç zonës së Mangalemit dhe Përroit, ishin shtrirë përtej lumit në lagjen «Goricë» dhe ato në hyrje të qytetit në lagjen «Murat Çelebi». Lidhja me lagjen «Goricë» sigurohej me një urë druri, e cila u rindërtua e gurtë prej Kurt Pashës. Në një dokument të vitit 1688 përmenden emërtimet e 22 lagjeve të Beratit. Nga ky dokument tërthorazi kuptohet se lagjja «Murat Çelebi» ishte mjaft e zhvilluar në këtë kohë. Me gjithë zhvillimin e madh të qendrës së hapur të banuar, lagjja brenda mureve rrethuese të kalasë vazhdoi të jetojë dhe jeton sot e kësaj dite.

Zhvillimi urbanistik i Beratit, megjithëse i paparaprirë nga plani rregullues, tregon qartë se është bërë mbi bazën e kritereve të shëndosha për kohën, të cilat presupozojnë qenien e një sërë parimesh dhe rregullash të detyrueshme. Udhëtari i mirënjohur turk i shekullit XVII Evlia Çelebiu, i cili jep një tablo tepër të gjallë të Beratit të kësaj kohe, në paraqitjen e funksionarëve të qytetit përmend dhe aganë e ndërtimeve, i cili kryente funksionin e urbanistit për kohën.

Ashtu si dhe në qytetet e tjera të kohës, edhe në




Fig. 2 Derat — Pamje e lagjes «Mangalem».

Berat, si qendër tregtaro-zejtare, pazari ishte qartësisht i ndarë nga pjesa tjetër e qytetit, që përfshinte lagjet e banuara. Ai shtrihej mjaft gjatë, duke pasur pranë qendrën e qytetit, ku binin në sy veçanërisht ndërtimet e kultit mysliman. Këtej nishin arteriet kryesore të rrugëve, të cilat të çonin në lagjet e banuara, duke u shumuar pastaj në një numër të madh rrugësh të dyta dhe të treta. Ato ishin të shtruara me kalldrëm, dhe kishin kuneta për mbledhjen dhe largimin e ujërave. Qytetit nuk i mungonin dhe kanalizimet. Një kolektor mjaft i madh, i cili grumbullonte ujërat e një përroi, duke kaluar përmes kompleksit të ndërtimeve të kultit me qendër Xhaminë Mbret dhe Teqen e Helvetive, i derdhte në lumë. Berati furnizohej me ujë kryesisht nga lumi; rrallë, sidomos në lagjen «Kala» dhe më pak në atë «Mangalem», ndërtoheshin dhe stera. Nuk mungonin edhe puset. Në lagjet e zonave fushore kishte gjelbërim dhe drurë pyjorë e frutorë.

Diferencimi klasor i popullsisë shfaqet qartas jo vetëm në tipologjinë e banesës beratase, por edhe në kompozimin urbanistik në diferencimin e lagjeve të banuara. Kështu, shtresat e privileguara të çifligarëve dhe funksionarëve të lartë shtetërorë apo fetarë, preferonin trojet e gjera, ku mund të ndërtonin banesa të mëdha të tipit me çardak, rrethuar nga oborre të gjera. Prandaj këto shtresa ndërtonin kryesisht në zonën e lagjes «Përroi», në lagjen «Murat Çelebi» dhe në pjesën e poshtme të lagjes «Goricë». Përkundrazi, masa e gjerë e zejtarëve dhe e familjeve që merreshin me kopshtari, në toka të vogla pranë qytetit, i bënë ndërtimet në Kala, Mangalem dhe në pjesën e sipërme të lagjes «Goricë».

Berati është një nga qytetet më të larme për sa i përket karakterit të ansambleve arkitektonike, për shkak të natyrave të ndryshme të trojeve, mbi të cilat ngrihen ato. Krahas ansambleve mjaft kompakte në terrene me pjerrësi të theksuar, ndeshim dhe ansamble me dendësi të paktë ndërtimesh në troje të rrafshta.

Qendra e banuar brenda mureve rrethuese, lagjja

«Kala», mbeti gjatë gjithë kohës, deri sot, një ansambël i rëndësishëm i qytetit. Siç përmendëm, ndërtimet e banimit në këtë lagje i përkasin kryesisht shekujve XVIII-XIX dhe veçanërisht gjysmës së dytë të këtij të fundit, kur dhe kjo lagje u përfshi në procesin e njohur të rindërtimit të banesave të vjetra. Rrugat kryesore e saj zë fill nga hyrjet e kalasë. Përveç arteries kryesore që përshkon për së gjati lagjen, ajo ndahet edhe në disa rrugë të tjera që gjithashtu përshkojnë në mënyrë gjatësore lagjen. Rrugë tërthore të shumta, ndër lidhin këto kalime gjatësore, duke krijuar një rrjet të dendur rrugor. Ndërtimet veshin në formë kurore kurrizin e kalasë, duke pasur orientim të detyruar, një pjesë nga lindja, ndërsa pjesa tjetër nga perëndimi. Dendësia e ndërtimeve është relativisht e madhe, por nuk mungojnë dhe oborret, përgjithësisht të vogla. Shpesh banesa del drejtpërdrejt në rrugë.

Nga ana e kompozimit urbanistik, vlera të rëndësishme ruan veçanërisht lagja «Mangalem», e cila paraqet rastin më skajor të ndërtimeve në terrene të pjerrëta. Trualli shkëmbor mjaft i thiktë i kësaj lagjeje ka kushtëzuar ndërtime në formë vargjesh paralele me banesa të bashkëngjitura që dalin drejtpërdrejt në rrugë. Kompaktësia e ndërtimeve këtu arrin pikën më të lartë, duke realizuar një shfrytëzim dhe lidhje të përsosur me truallin. Rrugët, gjithashtu, janë në formë brezash gjatësore dhe ndërpriten aty-këtu nga kalime tërthore, shpesh mjaft të thikta, në formë shkallësh. Së largu, ndërtimet shkrihen në një njesi të vetme, duke marrë pjesë në pamjen kryesore çdo ndërtim i veçantë. Ansambli shquan për kompozim të qetë dhe të ekuilibruar, përkundrazi kalimi nëpër të, të vë përpara zgjidhjes dinamike dhe tepër intime, për shkak të perspektivës së kufizuar dhe rrugicave të mbyllura nga të dyja anët me ndërtime të ngjeshura.

Lagja «Goricë», ngritur në një terren më pak të pjerrët, madje me një lloj ultësire buzë lumit, shquan për vendosjen disi të lirshme të ndërtimeve në pjesën e poshtme, ndërsa në të sipërmen ato përsë-

risin karakteristikat e lagjes «Mangalem». Në këtë lagje banesat shpesh paraqesin volumet e tyre në dallim nga ato të Mangalemit, ku kompaktësia e ndërtimeve shuan çdo mundësi për paraqitjen individuale të ndërtimeve.

Lagjja «Murat Çelebi», e cila shtrihet mbi një rrafsh të gjerë, shquhet për ndërtime relativisht të rralla. Banesat qarkohen me troje të mëdha e rrethohen me mure të larta. Rrugët, relativisht të gjera e plot dredhime, janë të varfra; portat e mëdha, ndonjëherë pajimet anësore apo të prapme të banesave, e aq më pak muret rrethuese, nuk thyejnë dot njëfarë monotonie, që është në kontrast të plotë me gjallërinë dhe dinamizmin e rrugëve në lagjet mbi terrene të pjerrëta. Gjelbërimi i dendur shpesh mbulon krejt banesën.

Me gjithë ndryshimet jo të parëndësishme në konceptin e formulimit të lagjeve të ndryshme të Beratit, i gjithë qyteti formon një njësi të vetme urbanistike. Ky fakt flet sheshit për nivelin e lartë, për kohën, të mjeshtrave shqiptarë, të cilët kanë ditur të shfrytëzojnë kaq mirë kushtet e dhëna, për të arritur gjatë shekujsh një realizim madhor në planin urbanistiko-arkitektonik, siç është qyteti i lashtë i Beratit.

BANESA E GURIT TË BARDHË

Guri i Bardhë është një fshat malor në krahinën e Matit. Ai ka një histori mjaft të lashtë. Gjatë mesjetës Guri i Bardhë ose Petralba ka qenë seli e familjes së Kastriotëve. Në afërsi të fshatit ruhen rrënojat e kalasë së qytetit të vjetër. Ky fshat ka qenë vendlindja e njërit prej figurave të shquara të kulturës sonë mesjetare, Pjetër Budit, i cili e përmend me krenari origjinën e vet nga ky vend. Ka qenë gjithashtu një qendër me rëndësi gjatë rrugës së vjetër që lidhte Dibrën me Tiranën. Gjurmë të shumta të kësaj rruge, si fragmente kalldrëmësh, ura të shumta, kulla mbrojtëse të rrugës si dhe kujtimi i haneve të dikurshme, ruhen deri në ditët tona.

Rëndësia e kësaj qendre të vjetër pasqyrohet dhe në banesën e saj. Një nga karakteristikat që të bie në sy në banesën e Gurit të Bardhë është gërshetimi i tipave të banesës fshatare me tipare dhe pajisje karakteristike për banesat qytetare. Nga ana tjetër, ato kanë një kompozim planimetrik e volumor specifik, që arriti të tipizohet dhe të bëhet i qëndrueshëm për një periudhë të gjatë kohe dhe që ndryshon me ato të krahinave përreth. Mjaft banesa janë të datuara, gjë që na jep mundësi ta vendosim këtë tip të veçantë banese në kohë dhe të ndjekim ndryshimet që pëson ai në kohë.

Banesat përgjithësisht janë dykatëshe, të ndërtuara në terren të pjerrët. Terreni ka kushtëzuar një kompozim volumor me gjysmëkat, d.m.th. një pjesë e katit mbështetet drejtpërdrejt mbi truall, ndërsa pjesa tjetër ngrihet mbi katin përdhes. Një vend me rëndësi në kom-




Fig. 3 Banesë e ndërtuar në vitin 1851.

pozimin planimetrik të banesës zë shtëpia e zjarrit, ose siç quhet ndryshe nga vendasit «shpia». Ajo paraprihet nga një hajat i hapur që del në pamjen anësore të banesës. Në pjesën ballore dalin dy kthina banimi, të cilat lidhen me shtëpinë, ose njëri prej tyre mund të ketë hyrje nga hajati. Nën kthinat e banimit, në katin përdhes, strehoheshin bagëtitë, ndërsa shtëpia në pjesën më të madhe është përdhese. Kati përdhes përdoret për mbajtjen e bulmetit dhe quhet «quri i bulmetit».

Shtëpia ka sipërfaqe mjaft të madhe dhe është kthina kryesore e familjes. Ajo është pa tavan, e shtruar me dhe të ngjeshur. Elementi kryesor i saj është vatra, e cila është vendosur në mes të kthinës, rreth 1 m larg

murit perimetral. Vatra është e zbuluar ose e mbuluar me një hinkë të madhe. Gropa e zjarrit thellohet në dysheme dhe ka formë rrethore në plan; «carujt e vatrës» e kufizojnë atë nga ana e murit. Në mur është hapur një nike e thellë, ose «gashorja». Pajisja e shtëpisë ishte e varfër. Në një kënd ndodhej arka e bukës dhe magjja, ndërsa disa banesa brenda në shtëpi kanë të ndërtuar furrën e pjekjes.

Edhe kthinat e banimit kanë një kompozim e pajisje karakteristike. Në pjesën fundore ndahet një hapësirë e ngushtë, ku janë vendosur banja ose hamami, musëndrat dhe parahyrja për në dhomë. Në pjesën e përparme, gjatë gjithë gjerësisë së ambientit, ngrihet një platformë ndenjjeje ose «hepe-a». Në muret anësore ndërtohet oxhaku me niken dhe dollapin e kafes përbri. Balli i kthinave të banimit është mbyllur me mur të hollë, i cili




Fig. 4 Banesë e ndërtuar në vitin 1870.

shpeshherë del jashtë rrafshit të mureve të katit përdhes dhe përmban një varg dritaresh të mëdha.

Banesat janë të ndërtuara me gurë të lidhur me baltë e breza druri. Muratura e ballit të banesës ngrihet me skelet druri, mbushur me gurë porozë e të lehtë që quhet «shpa». Strehët e çatisë dalin rreth 1 m tej rrafshit të mureve të katit dhe janë dyfishe, si zgjatim i trarëve horizontalë dhe i bishtave të çatisë.

Një banesë me interes e këtij tipi, me një trajtim të arritur arkitektonik e me një përpunim të pasur dekorativ, ka arritur deri në ditët tona. Kjo banesë është e datuar në vitin 1805, pra është një nga shembujt me datë më të vjetër në arkitekturën fshatare.

Në këtë banesë gjejmë një zgjidhje tashmë të kristalizuar planimetricke. Kthinat kanë funksionin e tyre të përcaktuar, ndërsa kompozimi i banesës ka marrë formë përfundimtare, në përputhje me funksionin dhe veçoritë e terrenit. Kthina e shërbimit dhe e punëve të përditshme të familjes ka përmasa të mëdha, vendoset mbrapa, duke u ngritur pjesërisht mbi truall dhe shkëputet nga kthinat e tjera, të cilat dalin në ballë të ndërtesës. Një zgjidhje të plotë kanë gjetur gjithashtu pajisjet dhe elementet kompozicionale të vetë kthinave ballore. Nga ana tjetër, në këtë banesë kompozimi dhe pajisja e brendshme janë të shoqëruara nga një zgjidhje konstruktive dhe trajtim dekorativ mjaft i pasur. Terreni i pjerrët është përpunuar lehtë për ndërtimin e muraturës së katit përdhes, duke ruajtur dhe truallin natyror shkëmbor për mbështetje. Nga ana e hyrjeve, terreni është përpunuar në formë tarracash.

Muratura, ndonëse është e lidhur me baltë dhe breza druri, shquhet për një përpunim të kujdesshëm të gurëve dhe vendosjes së tyre në muraturë, në rreshta të rregullt e të drejtë. Dallohen në mënyrë të veçantë në këtë muraturë qoshet e punuara pastër me gurë të skalitur, ku nuk mungon dhe përpunimi dekorativ i tyre. Në të është gdhendur motivi i diellit, nga i cili zbret një filetë e hollë e skalitur gjatë gjithë lartësisë së muraturës.

Balli i katit të sipërm të banesës, nga ana e pjerresisë më të madhe, është i nxjerrë lehtë mbi bllokun masiv e të mbyllur të katit përdhes. Mjeshtrit i ka mjaftuar kjo dalje e paktë për të thyer volumet, për t'i shkëputur e dalluar ato nga trajtimi dhe materiali i ndryshëm, me të cilin janë ndërtuar.

Muratura e hollë dhe e lehtë e katit, e nxjerrë pak përpara dhe e gjallëruar me një varg dritaresh të mëdha, ngrihet mbi një taban druri dhe mbështetet mbi bishtat e dalë të trarëve të dyshemesë. Tabani, bishtat e drurit si dhe dërrasat që mbyllin hapësirat ndërmjet bishtave, janë profiluar dhe gdhendur me kujdes. E njëjta përkujdesje konstruktive dhe dekorative duket dhe në strehën e çatisë. Një strehë mjaft e dalë e rrethon dhe e mbron muraturën. Dalja e madhe e strehës ka bërë të nevojshme mbështetjen e saj në qostekë të hollë, paksa të lakuar, me fundet e tyre të gdhendura. Një përpunim të kujdesshëm dekorativ përmbajnë dhe elementet e brendshme, si dyert, dollapet e musëndrat, mbulesat e kamareve etj.

Në një banesë tjetër, datuar në vitin 1851, gjejmë një skemë planimetricke mjaft të përbërë. Megjithatë kjo skemë është e lexueshme dhe nuk është vështirë që të kapet në të bërthama kompozicionale e thjeshtë, e pasuruar me kthina të reja.

Banesa është simetrike e ndërtuar për dy familje. Çdo pjesë përmban «shpinë» të paraprirë nga hajati si dhe nga dy kthina. Kompozimi planimetric i banesës ose i seksionit ndryshon nga ai i zakonshmi me rreshimin karakteristik të kthinave përpara «shpisë». Megjithatë, mbas kaq vjetësh, ruhet i njëjti kompozim e trajtim i kthinave si dhe e njëjta mënyrë pajisjeje. «Shpija» me përmasa të mëdha ngrihet pjesërisht mbi truall, ku është e vendosur vatra e larguar nga muri fundor. Ajo ka të njëjtat elemente dhe pajisje. Kthinat me bllokun fundor, musëndrat, banjën dhe nyjen sanitare të veçantë dhe «hepe-n» në ballë, ku muri i hollë përmban vargun e dritareve të mëdha, janë gjithashtu të njëjta me ato të shembujve më të vjetër.

Në pamjen ballore dalin përpara dy volume simetrike karshi pjesës qendrore të futur. I gjithë balli i katit të sipërm është i ndërtuar me mur të hollë me gurë porozë, që mbush skeletin e drurit, por nuk e ka më atë shkëputje ose dalje nga muratura e katit për-dhes. Streha vazhdon të jetë mjaft e dalë, dyfishe, me bishtat e profiluar. Punimi i muraturës është i pastër, ka përpunim dekorativ të qosheve, ndërsa brezat e drurit nuk dalin në sipërfaqen e jashtme të murit.

Qëndrueshmërinë e skemës planimetrike e dëshmon një banesë tjetër e datuar në vitin 1870. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një banesë me dy seksione, ose me dy bërthama të thjeshta të bashkëngjitura për dy familje. Në këtë mënyrë është krijuar një ndërtim krejt simetrik karshi murit ndarës tërthor. Në ndryshim me shembullin e mësipërm, këtu çdo seksion përsërit plotësisht skemën planimetrike dhe kompozime volumore të kristalizuara që në fillimin e shek. XIX. Megjithatë kjo banesë mbetet mbrapa për sa i takon trajtimin arkitektonik, përpunimit dekorativ dhe nuk përmban më të gjithë ato elemente kompozicionale të kthinave.



Tiparet e veçanta dhe të qëndrueshme të banesës së Gurit të Bardhë i kanë dhënë asaj një karakter që e dallon nga banesat e tjera të krahinës së Matit dhe të krahinave të tjera. Por me gjithë dallimet, ajo afrohet në disa konceptime me banesat më të lashta të këtyre krahinave. Kështu, p.sh ndërtime në truall të pjerrët, me kompozim volumor, me gjysmë kat takohen shpesh dhe në krahina të tjera të vendit. Shtrirja horizontale e kompozimit planimetrik, me shtëpi zjarri, ishte karakteristike e banesave në fshatrat e Tiranës dhe në banesat e vjetra të Matit. Diferencimi i një pjese të dhomës së miqve, vëndndenja komode e trajtuar me kujdes, janë të njëjta për këto banesa.

Tipat e rinj të banesave, karakteristikë për krahinë

e Matit, ndonëse u futën në Gur të Bardhë, siç është p.sh. një kullë në lagjen «Mansaj», e ndërtuar në fillim të këtij shekulli, nuk arritën të përgjithësohen. Përkundrazi, tipi i vjetër i banesës së Gurit të Bardhë u përdor për një periudhë të gjatë kohe nga masat e gjera të popullsisë. Ky tip banese duket mjaft i vjetër. Në banesën e datuar në vitin 1805 i gjejmë të formuara plotësisht të gjitha elementet thelbësore të tipit të arritura në një shkallë të lartë përsosërie. Ky fakt na shtyn të mendojmë se formimi i këtij tipi banese në Gur të Bardhë duhet të ketë ndodhur shumë kohë më parë dhe do të ketë qenë i përgjithshëm gjatë shekullit XVIII.

Nga ana tjetër, shumë elemente të kësaj banese hedhin dritë mbi karakterin e vendbanimit si dhe mbi karakterin e marrëdhënieve ekonomike e shoqërore të popullsisë.

Kompozimi dhe pajisja e kthinave të banimit me bllokun fundor, banjat e musëndrat, me trajtimin e ballit të kthinës, me «hepe-n» e dritaret, janë karakteristikë e banesave qytetare, të cilat takohen rëndom në të gjitha qytetet e vendit tonë dhe të vendeve fqinje. Po të kihen parasysh edhe faktorët e tjerë, si vendndodhja e saj gjatë rrugës së rëndësishme të karvanëve Dibër-Tiranë, ekzistenca e haneve të shumta dhe e kullave mbrojtëse të rrugës, atëherë del e qartë rëndësia e madhe e Gurit të Bardhë si një qendër me peshë në këto krahina.

Por me kalimin e kohës, gradualisht rëndësia e kësaj qendre po binte, derisa në gjysmën e dytë të shek. XIX mori karakterin e një fshati të madh. Në banesë ky proces u pasqyrua në varfërimin e elementeve dhe pajisjeve të kthinave, në humbjen e karakterit qytetar të tyre si dhe thjeshtëzimin e trajtimit arkitektonik e dekorativ të banesës.

Ndonëse elementet qytetare në banesën e Gurit të Bardhë janë të qarta, po kaq të pranishme dhe të qarta janë dhe elementet e banesës fshatare. Këto shprehën në ruajtjen për një kohë të gjatë të shtëpisë së zjarrit,

në kompozimin planimetrik e volumor të banesës. Kthina të tilla ishin karakteristike për familje të mëdha të karakterit patriarkal, të cilat shtronin kërkesën për ndërtimin e një kthine qendrore për grumbullimin e gjithë pjesëtarëve të familjes dhe për kryerjen e punëve të ditës. Bashkekzistenca e tipareve fshatare me ato qytetare është një fakt i njohur dhe për qendrat e tjera qytetare të vendit, kur gjatë shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX, ndikimi i banesës fshatare mbi atë qytetare ishte mjaft i ndjeshëm.

Humbja e disa tipareve qytetare të banesës, që u shfaq kryesisht në pajisjen e brendshme, la të paprekur zgjidhjen planimetrike e funksionale të banesës, e cila nuk kishte të bënte me ndikimet qytetare, por ishte një zgjidhje e arritur për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të popullsisë së kësaj qendre.



Stilian Adhami

NJË ANSAMBËL MONUMENTAL NË MYZEQE

Në anën e djathtë të rrugës automobilistike që shkon nga Lushnja për Fier, sipër fshatit të Kolonjës, mbi një rën nga kodrat që ndajnë Myzeqenë e Madhe nga Myzeqeja e Vogël, gjendet Manastiri i Ardenicës me faltoren e vet të Shën Mërisë.

Për vlerën historike dhe artistike ky ansambël monumental është vënë në mbrojtje shtetërore.

Mundet që ky vend të ketë trashëguar emrin e lashtë




Fig. 5 Manastiri i Ardenicës

të qytetit Arnissa, që shënohet nëpër harta në krahun e majtë të lumit Shkumbin, në tokën e Myzeqesë. Data e saktë e themelimit të këtij manastiri nuk dihet. Nga një mbishkrim i murosur përbri portës kryesore të hyrjes së tij, ku lexohet greqisht 1 maj 1477, del se ky monument duhet t'i përkasë mesjetës së mesme. Për këtë flasin edhe ato gjurmë që vërehen në truallin brenda tij. Ka mundësi që viti 1477 t'i përkasë rindërtimit të tij. I dëmtuar nga koha, ai është rindërtuar disa herë edhe në vitet 1743-44. Pikërisht të shek. XVIII janë kisha dhe kthinat e sotme të vendosura mbi muret e manastirit.

Në truallin e këtij ansambli, si p.sh. në oborr, në kambanore, në qilar, në pus etj., vërehen një sërë relievesh të vjetra, relieve e pjesë arkitektonike të futura nëpër mure, si në shumë faltore të tjera të Myzeqesë, të sjella me sa duket nga qyteti i lashtë i Apolonisë. Aty-këtu rreth manastirit, në një truall të gjerë duken gurë themelesh të vjetra që na bëjnë të mendojmë se dikur ka pasur mjaft ndërtime rreth tij.

Ky ansambël, godinë e gjerë prej dy pjesësh të ndara me mur, meqë ndodhet në vend të lartë dhe është një ndërtesë e fortë, mund të ketë shërbyer edhe për qëllime ushtarake. Kthinat e banimit dhe qelitë e klerikëve komunikonin ndërmjet tyre me anë të një çardaku të mbuluar. Këto kthina si edhe ahuret e kafshëve etj., si në të gjithë manastiret, edhe këtu hynin dikur në punë për të pritur fshatarët e besimtarë të tjerë, që rrinin për ditë festash e panairesh. Sipas dokumenteve, që nga shek. XIX dhe fillimi i shek. XX në këtë vend çdo 15 gusht zhvillohej panair.

Gojëdhëna popullore thotë se mjeshtrit që ndërtuan Manastirin e Ardenicës kanë qenë po ata që ndërtuan Manastirin e Pojanit e që ndodhen në një pellg. Qarkullon edhe gojëdhëna se themelet e këtyre dy manastireve janë hedhur më 1282 me iniciativën e Andronikut II Paleologut, perandorit të Bizantit. Ndoshta këtë vërtetojnë dhe afresket kushtuar kësaj figure në Pojan e Ardenicë.

Ka të dhëna se pranë këtij manastiri ka pasur edhe një bibliotekë të pajisur me libra, sidomos të shtypura në Voskopojë e Venedik. Tregohet se pasuria bibliotekare e saj ka qenë mjaft e përmendur, sa që nga fillimi i shek. XIX vinin aty me shumicë fetarë e studiues edhe nga Greqia. Nga zjarret e mëvonshme kjo bibliotekë u shkatërrua dhe nuk ngelën veçse disa vëllime, ndërsa mjaft sende të vyera nga pajisjet kishtare prej ari, argjendi etj., u grabitën.

Po ashtu, aty ka funksionuar edhe një shkollë e mesme klasike, ku mësimet jepeshin greqisht dhe kishte një internat me më tepër se 50 nxënës. Por thuhet gjithashtu se ky manastir, i cili kishte më se 60 000 groshë të ardhura vjetore, mbi 1000 rrënjë ullinj, ku punonin 38 familje bujqish nga fshatrat e Myzeqesë, shpenzonte për këtë shkollë një shumë fare të vogël. Aty nga viti 1905 në këtë shkollë ka dhënë mësimë shqip fshehtas Mësuesi i Popullit Jani Minga.

Në shekujt XVII e XVIII manastiri u pasurua mjaft jo vetëm nga shfrytëzimet e ndihmat financiare, por edhe nga ndihma të tjera të ardhura nga «Shoqëria e Manastirit të Shën Mërisë së Ardenicës», e formuar nga të mërguar shqiptarë në Poloni e në Hungari. Kjo shoqëri, që kishte krijuar një arkë ndihmash për këtë manastir, ia dërgonte ndihmat drejtpërdrejt ose me ndërmjetësinë e miqve dhe farefisit që kishin në qytetin e atëhershëm të lulëzuar të Voskopojës, ku deri kohë më parë ekzistonte dhe një metoq (aneks) i këtij manastiri. Anëtarët e kësaj shoqërie kanë pasur letërkëmbime me kujdestarët e manastirit, emrat e të cilëve përmenden në regjistrat e tij.

*
* *
*

Zona e Myzeqesë në shek. XVIII ka qenë e begatë në ndërtime kulturi të krishterë; kështu u ndërtuan faltore në Libofshë (1776), Kolkandas (1782), Kozare (1791), Vanaj (1795), Karavasta (1797), Bishqethëm (1798) etj.




Fig. 6 Kisha e fshatit Kozarë.

Ky vrull ndërtimor nuk pushon edhe nga fillimi i shek. XIX. Më 1801 kemi pikturimin e ikonostasit të kishës së Kadipashait, më 1806 të asaj të Kozarës, më 1811 ato të Toshkëzit dhe të Krutjes së Sipërme.

Por vlerat historike e artistike të Manastirit të Ardenicës i tejkalojnë ato. Kisha është e një tipi të thjeshtë bazilikal me tavan, që datohet si ndërtim i vitit 1743. Është ndërtuar në kohën e peshkopit myzeqar Metodi nga Bubullima, me iniciativën e të cilit në ato kohë u bë dhe rindërtimi i vetë manastirit. Si karakteristika të përbashkëta të këtyre lloj bazilikave janë: vëllimi i madh, mbulesa me çati druri, numri jo i vogël i dritareve, absida shumëfaqëshe dhe të dekoruara me harqe dhe pilastra. Kisha, e ndrequr disa herë, ka dy porta, njëra prej së cilës mban datën 1754. Në këtë monument të tërheqin vëmendjen veçanërisht afresket e brendshme me vlera të mëdha artistike dhe

ikonostasi i gdhendur me kujdes e shije, ku ruhet e gjithë pajisja prej druri të praruar, punuar në vitin 1745. Në këtë monument kanë derdhur energjitë e tyre krijuese piktorët e shquar shqiptarë Kostandin dhe Athanas Zografi nga Korça, të cilët kanë pikturuar edhe




Fig. 7 Kisha e Manastirit të Ardenicës.

në Voskopojë, Vithkuq Korçë e deri dhe jashtë vendit. Në afresket e kësaj kishe gjendet edhe portreti i Jan Kukuzelit, muzikologut të shquar durrsak të shek. XII, gjë që dëshmon dhe për kulturën e gjerë të këtyre piktorëve. Kisha është e tëra e zbukuruar me afreske. Piktura mungon vetëm në gjysmën perëndimore të murit verior. Në pjesën e sipërme të mureve dallohen skenat e testamentit të ri dhe të vjetër; ato poshtë përfaqësojnë personazhe të përmendura, profetë, perandorë e mbretër; në fund përfytyrohet kryeengjëlli Mëhill dhe skena e vdekjes së Shën Mërisë, që mban datën 1744. Piktoret korçarë aty patën pikturuar me kostum vendi edhe Shën Nikodhimin nga Vithkuqi, martirizuar në Berat aty nga fillimi i shek. XVIII, pikturë që ka rënë me gjithë suva gjatë një meremetimi, që është bërë atje prej kohe.

Ikonostasi i kësaj kishe është pikturuar në shek. XVIII nga piktori tjetër i shquar Kostandin Shpataraku. Midis ikonave më me interes është ajo, që përfytyron Karl Topinë (1359-1388), sundimtarin dhe princin e Arbërisë. Me vlerë artistike janë gjithashtu ikonat e tjera të Shpatarakut me temë «Gjuetia e shenjtit», «Shërimi i të verbëtisë», «Shën Grigor Theologu», «Kryeengjëlli Gabriel» etj. Këto dy të fundit gjenden në «derën e bukur» të ikonostasit.

Të tërheq vëmendjen edhe fakti tjetër me interes. Në tri prej ikonave të këtij ikonostasi figurojnë mbi-shkrime, sipas të cilave këto ikona janë dhurata nga esnafët e bakejve, të bakërshinjeve dhe të mjeshtreve të Voskopojës. Pa dyshim, piktori ynë Shpatarak duhet të ketë pasur porosi prej voskopojarëve të pasur për të stolisur me ikona dhe kishat e tyre të mëdha e të shumta, megjithëse sot në Voskopojë nuk gjendet asnjë ikonë e pikturuar prej dorës së tij, por kjo është e lidhur patjetër me shkatërrimet e njëpasnjëshme që ka pësuar ky qytet i mesjetës së vonë dhe sidomos me grabitjet e pësuar nga të huajt gjatë Luftës së Parë Botërore.

Me shumë interes për gjuhën shqipe është një mbi-

shkrim i gdhendur mbi ikonën gravurë të Shën Mërisë më 1731 në gjuhën shqipe, me shkronja greke. Mbi-shkrimi, që ka dalë nga dora e Nektor Terpo Voskopojarit (autor i librit «Besa»), ka këtë përmbajtje: «Virgine Mame e Perëndis uro pre nae fajtorëtoi — 1731». Ky është një ndër dokumentet e hershme që njihen për shqipen; kjo gravurë dëshmon përdorimin e gjuhës shqipe në masa të gjera të popullsisë, në një kohë kur botimet shqipe janë të rralla.

Përballë këtyre vlerave artistike e historike bie në sy një kontrastim i keq i tavanit dhe i shtyllave të pikturuara aty nga fillimi i shek. XX me një shije krejtësisht folklorike.

Në truallin brenda manastirit, ku ndodhet kisha, lartësohet në trajtë katrore kambanorja e bardhë e saj. Kambana e madhe mban datën 1708, ndërsa të tjerat më të vogla janë të vitit 1738. Pak a shumë e njëjtë me atë të Manastirit të Pojanit, kambanorja është rindërtuar më 1925, siç dëshmohet nga vetë mbishkrimi që ajo mban. Në këtë ndërtim është murosur edhe një basoreliev — figurë, që sigurisht është marrë nga ndonjë monument mortar.

**NJË MONUMENT HISTORIK ME VLERA ARKI-
TEKTONIKE NË RRETHIN E TIRANËS**

Monumenti për të cilin po shkruajmë është një banesë që ndodhet në fshatin Alltatë në verilindje të Bal-dushkut. Kjo banesë është e ndërtuar në shpatin jugor të një kodre, në vendin ku formohet një tarracë e har-kuar me pjerrësi të vogël, shumë e përshtatshme për ndërtim.

Duke qenë e veçuar nga fshati dhe e ndërtuar në një vend dominues me fushëpamje të gjerë, gjatë Luftës



Fig. 8 Pamje e përgjithshme e banesës.



Fig. 9 Pamje veriore e banesës.

Nacionalçlirimtare kjo banesë u zgjodh për t'u vendosur Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇSH dhe shoku Enver Hoxha. Gjatë qëndrimit në këtë banesë, prej 13 shtatorit 1943 deri më 28 tetor 1943, shoku Enver Hoxha dhe anëtarët e tjerë të Shtabit mbanin lidhje me të katër anët e vendit nëpërmjet korrierëve partizanë. Në këtë periudhë shoku Enver mori pjesë në formimin e Brigadës 3-të Sulmuese në Arbanë, udhëhoqi drejtpërdrejt luftën e Arbanës kundër nazistëve gjermanë etj.

Ngjarje me rëndësi të madhe historike, që u drejtua nga shoku Enver, në kohën kur Shtabi i Përgjithshëm i U.N.Çl. ndodhej në Alltatë, ishte goditja e Asamblesë kuislinge me top, më 18 tetor 1943.

*

*

*

Për hartimin e projektit të restaurimit të kësaj godine na dolën dy çështje që kërkonin zgjidhje. E para

ishte që me restaurimin e banesës ta kthenim atë në gjendjen që ka pasur në kohën e momentit historik. Çështja e dytë ishte ajo që t'i rikthenim banesës disa elemente me vlera arkitektonike dhe funksionale që i kishte humbur nga koha, gjurmët e të cilave ruheshin pjesërisht. Të dy këto probleme ishin shkruar tek njëri-tjetri, por në pjesë të veçanta të banesës dilte më tepër në dukje problemi i dytë.

Banesa përbëhet nga dy godina dykatëshe ndërtuar me gurë e lidhur me llaç balte. Për qëllim studimi po i emërojmë: A — ndërtesa e anës lindore dhe B — ndërtesa e anës perëndimore.

A. — *Ndërtesa e anës lindore.* Përbëhet nga dy dhoma me oxhak në katin e sipërm, dhe një ahur për bagëtinë që zë gjithë sipërfaqen e katit përdhes. Një rampë shkallësh guri, që është ndërtuar pas Çlirimit dhe që i përshtatet murit lindor të ndërtesës, të ngjitur në të njëjtin shesh pushimi, ku mbështeteshin shkallët prej druri me drejtim pingul në faqen lindore. Prej këtej,



Fig. 10 Pamje lindore e banesës.



Fig. 11 Porta e hyrjes e banesës.

nëpërmjet një dere dy kanatëshe, paturat e së cilës përbëhen nga tri blloqe gurësh masivë dhe një i katërt i harkuar shërben si arkitra, hyhet në njërën prej dhomave me oxhak. Kjo është shtruar me dysheme dërrase, nuk ka tavan, është e suvatur dhe e lyster me gëlqere nga brenda. Ka dy dritare në faqen lindore dhe dy në atë jugore, me madhësi 60 x 90 cm dhe të pajisura në faqen e brendshme me kapakë druri dykanatësh. Midis dy dritareve të faqes jugore ndodhet oxhaku, vatra e të cilit është rreth 5 cm e ngritur nga dyshemeja dhe e shtruar me argjilë dhe rrasa guri. Në të dy anët e oxhakut ka nga një kamare dhe një dollap muri të vo-

gël, të caktuar për mbajtjen e kafesë, pijeve dhe enëve të tyre. Sipërfaqja e kësaj dhome është rreth 25 metra katrorë, ndërsa lartësia 2,55 metra nga dysheja deri tek trarët horizontalë të konstruksionit të gatisë.

Është pikërisht kjo dhomë që shërbente si ambient pune për shokët e Shtabit të Përgjithshëm të U.N.ÇI, kurse tjetra ngjitur, e ndarë me një mur të lehtë me skelet druri mbushur me qerpiç, që komunikon me anën e një dore të hapur në vendin e takimit të murit ndarës




Fig. 12 Dyert e kalimit nëpër kthina.

me murin perimetral lindor, shërbente si dhomë pune dhe pushimi për shokun Enver Hoxha. Edhe kjo është e shtruar me dysHEME dërrase e pajisur me oxhak dhe vatër paksa të ngritur nga dysHEMEJA. Ka dy dritare, në faqen lindore, me kapakë dërrase dy kanatëshe nga brenda. Sipërfaqja e dysHemesë së kësaj është rreth 20 metra katrorë. Në të dy anët e oxhakit ka nga një kamare dhe në të majtë një dollap muri të vogël sipër kamares. Një dollap tjetër muri është lënë pranë vendtakimit të murit perimetral verior, ku ndodhet oxhaku dhe murit perimetral lindor. Ky dollap përdorej nga shoku Enver Hoxha për vendosjen e materialeve të ndryshme të punës. Edhe kjo dhomë ka të njëjtën lartësi me të parën, është pa tavan, muret i ka të suvatuara me llaç balte dhe të lyera me gëlqere.

Të dy dhomat, në faqen perëndimore, pranë vendtakimit me murin ndarës tërthor, kanë nga një derë që të nxjerr në një pasazh kalimi. Majtas kanë qenë një palë shkallë druri që të zbrisnin në oborrin e shtruar me kalldrëm me gurë lumi. Prej këtej, nëpërmjet një dere të hapur pranë qoshes jugperëndimore të mureve perimetrale, hyhet në haur. Menjëherë sa hyn në këtë kthinë të bie në sy një shtyllë druri, që shërben si përforcuese e traut horizontal, i cili mban konstruksionin e murit ndarës të të dy dhomave të katit të sipërm. Si shtroje e kësaj kthine shërben një shtresë argjile e ngjeshur. Në muret perimetrale nuk ka hapësira për ndriçim, me përjashtim të një frëngjie në murin jugor, e cila ka shërbyer më tepër për ajrim se sa për ndriçim.

Në katin përdhes, të bien gjithashtu në sy katër kamare me përmasa 55x40x35 cm të hapura në murin jugor. Po një kamare të tillë ka edhe në murin lindor dhe të pesta kanë në mesin e tyre nga një të çarë të vogël që përshkon gjithë trashësinë e murit. Me interes është fakti që në këto kamare kanë qenë vendosur kosheret e bletëve.

B. — *Ndërtesa perëndimore.* Përbëhet nga një kthinë, që fshatarët e thërrasin «shpia e zjarrmit», nga një

dhomë me oxhak në katin e sipërm dhe një «burg gjaje» (ahur) në katin përdhes.

Nëpërmjet një dere një kanatëshe të hapur në mesin e murit perëndimor hyhet në «shpinë e zjarrit», që ka lartësinë e dy kateve. Ajo është e shtruar me një shtresë dheu të ngjeshur të lustruar me baltë, karakteristike kjo për banesat fshatare të rrethit të Tiranës. Shtëpia e zjarrit ka një sipërfaqe prej 25 metër katrorë. Muret i ka të pasuvatuara. Në mesin e brinjës së takimit të faqes veriore me truallin ndodhet vatra pa oxhak. Vatra, paksa e ngritur nga trualli, është shtruar dhe bor-




Fig. 13. Gjurmët e telizit.




Fig. 14 Hyrja në dhomën e miqve.

duruar me cepa rrasash guri. Në faqen e murit, pranë të cilit ndodhet vatra, ka tri kamare të vogla me përmasa 30x35 cm, të ngritura nga trualli 85 cm dhe mbi çdo kamare ka nga një copë binari që del nga faqja e murit. Ky i fundit si dhe kamaret kanë shërbyer për të vendosur sende të ndryshme të përdorimit shtëpiak. Midis hyrjes dhe vatrës, në faqen e brendshme të murit perëndimor ekzistojnë gjurmët e një furre pjekjeje, kanali i tymit i së cilës, i hapur në brendësi të murit, nuk ka tymar mbi çati. Përballë hyrjes dhe pranë qoshes jug-

-lindore të shtëpisë së zjarrit janë shkallët e lehta prej druri, që të ngjitin në katin e sipërm në *dhomën e mikut*, nga brenda.

Hyrja në dhomën e mikut është në drejtim të kundërt me atë të shtëpisë së zjarrit, pra në murin lindor të kësaj ndërtese.

Nga oborri i shtruar me kalldrëm, të cilin e kemi përmendur kur folëm për ndërtesën lindore, nëpërmjet një shkalle druri ngjitesh në pasazhin që lidh të dy ndërtesat, majtas të cilit ndodhet dera e hyrjes për në dhomën e mikut. Kjo dhomë është shtruar me dysHEME dërrase me sipërfaqe 25 metra katrorë dhe deri tek trarët horizontalë të konstruksionit të çatisë ka lartësinë 2,45 metra. Ka tri dritare të thjeshta për ndriçim, pak më të vogla se ato të ndërtesës lindore, nga të cilat njëra ndodhet në faqen e murit lindor dhe dy të tjerat në atë jugor. Edhe këto dritare janë pajisur nga faqja e brendshme me kapakë dërrase dy kanatëshe. Midis dy dritareve të faqes jugore ndodhet oxhaku me vatrën të ndërtuar njësoj si tek dy dhomat e ndërtesës lindore. Tamburi i këtij oxhaku, dikur i ndërtuar me thupra dhe suvatuar me baltë, tani mungon. Në anën e djathtë të oxhakut ka një kamare, kurse në anën e majtë ka dy të tilla të vendosura njëra sipër tjetrës. Përdorimi i këtyre kamareve është i njëjtë me ato të dy oxhakëve të ndërtesës lindore. Kjo dhomë ka edhe një dollap muri të vogël në faqen perëndimore. Në qoshen verilindore të kësaj dhome, në vendin e takimit të murit lindor me murin ndarës tërthor prej guri, është një derë dhe mbas kësaj janë shkallët e brendshme prej druri që të zbrisin në «shpinë e zjarrmit»; kurse në qoshen veripe-rëndimore shihen qartë gjurmët e një dera, që ka shër-byer për të dalë në «teliz»¹). Gjurmët e këtij ballkoni shihen qartë në pamjen perëndimore të ndërtesës.

1) Telizi është një korridor i ngushtë i ndërtuar me lëndë druri, i dalë nga faqja e murit në formën e një ballkoni të mbyllur me dërrasa dhe ka funksione komunikimi.

Poshtë dhomës së mikut, në katin përdhes, kemi «burgun e gjasë» me sipërfaqe 24 metra katrorë dhe lartësi 2 metra. Hyrja për në «burgun e gjasë» bëhet nga oborri nëpërmjet një dere dykanatëshe. Në murin jugor të kësaj kthine ka dy frëngji që shërbejnë më tepër për ajrim se sa për ndriçim. Shtrojen e ka të ngjashme me «burgun e gjasë» të ndërtesës lindore. Kthina që po përshkruajmë, në murin perëndimor ka gjurmët e një dere, hapësirën e së cilës e gjetëm të murosur. Kjo ka pasur disa ndarje të brendshme, me thupra, që shërbenin për qëndrimin e llojeve të ndryshme të bagëtisë.

Pasazhi i komunikimit ndërmjet dy ndërtesave, i ndërtuar me dysheme dërrase, trarët e së cilës nga njëra anë mbështeten në murin jugor të një kthine, që ka shërbyer si vend për depozitim të produkteve ushqimore dhe nga ana tjetër mbështeten në pesë shtylla druri të futura në tokë, ka pësuar ndryshime të mëdha. Kohët e fundit këtu është ndërtuar një dhomë për fjetje mbi muret e kthinës së rezervave ushqimore, e kjo e fundit merr pjesë në formulimin e oborrit të shtruar me kalldrëm së bashku me murin rrethues të tij që lidh të dy ndërtesat në anën jugore. Në mesin e këtij muri rrethues është porta e madhe dykanatëshe, nëpërmjet së cilës bëhet komunikimi me ambientin jashtë banesës.

Teknika e ndërtimit

Të dy godinat e kësaj banese janë ndërtuar me të njëjtën teknikë ndërtimi: mur guri, me trashësi 50 cm, të lidhur me llaç balte dhe të niveluar e përforcuar me breza druri 4 cm të vendosur në lartësi 60 deri 90 cm nga njeri-tjetri. Qoshet e mureve janë me gurë më të mëdhenj dhe pak të punuar. Fugat e mureve të ndërtesës lindore janë në veshur me gëlqere dhe krijojnë përshypjen sikur sipërfaqja e murit është suvatuar. Brezat e drurit këtu kanë distancë pak më të madhe se

ato të ndërtesës perëndimore. Në ndarjen e dy dhomave të ndërtesës lindore është përdorur skeleti i drurit, boshllëku i të cilit është mbushur me qerpiç, teknikë kjo mjaft e përhapur në Shqipërinë e Mesme.

Dyshemetë e katit të sipërm janë të gjitha me lëndë druri, kurse kati përdhes ka një shtresë dheu të lustruar me baltë, që i përmbahet traditës ndërtimore të banesave popullore të rrethit të Tiranës.

Çatia me strehë që dalin 45 cm jashtë mureve, është ndërtuar me konstruksion druri dhe e mbuluar me tjegulla vendi.

*
* *

Duke u nisur jo aq nga teknika ndërtimore se sa nga kompozimi planimetrik i kësaj banese mendojmë që më e hershme duhet të jetë ndërtesa perëndimore dhe e ngritur nga mjeshtrit shetitës dibranë ku kanë dhënë kontributin e tyre edhe mjeshtrit tiranas.

Ndërtesa perëndimore i përket tipit të zhvilluar, në planimetri dhe lartësi të banesës fshatare tiranase.

Ndërtesa lindore, për nga kompozimi planimetrik, ka ngjashmëri me disa banesa të rrethit të Tiranës, të Matit dhe të krahinës së Çermenikës, ndërsa fryma arkitektonike me të cilën është ndërtuar kjo të shpie më tepër në krahinat e Jugut sidomos në ato korçare.

Prandaj mendojmë që për ngritjen e saj kanë dhënë kontributin e tyre edhe mjeshtrit shetitës të ardhur nga krahinat e Korçës.

Duke përfunduar duhet të themi që me restaurimin e banesës krijohet një objekt mjaft i përshtatshëm muzeal, ku mund të ngrihet edhe muzeu krahinor i zonës së Baldushkut.

UJESJELLES DHE ÇEZMA TË VJETRA NË VENDIN TONË

Një traditë mjaft e njohur që në kohët antike ka qenë ajo e ndërtimit të ujësjellësve në vendin tonë. Deri në ditët tona në Xare të Sarandës, në Durrës etj ruhen gjurmë ujësjellësish antikë. Nga burimet historike rezulton se mjeshtrit shqiptarë të ndërtimit të ujësjellësve ishin të njohur bile jashtë kufijve të vendit. Në një botim të shekullit të kaluar thuhet se në krahinën e Lunxherisë, në katundet Nokovë, Dhoksat e Këllez punonte vëllazëria e pusaxhinjve-suterehinjve. Gjatë mesjetës ata ishin pusaxhinjtë e privilegjuar të Stambollit, që u mbajtën edhe më vonë nga sulltanët. Veprat e tyre solide mbulojnë të gjitha krahinat e lindjes. Akuaduktet e tyre në pjerrësi, zgjidhur me saktësi e ngandonjëherë me gjatësi nga 15-20 lega, i ngjajnë njëri-tjetrit aq sa nuk mund të dallohen ato të djeshmit nga ata të 2000 vjetëve më parë.

Ende sot ruhen një sërë ujësjellësish të ndërtuar gjatë mesjetës që furnizonin me ujë nga burimi qendrat e banuara; kalatë apo dhe kanalet që përdoreshin për vaditjen e tokave. Ujësjellësit kalonin me urë-kanale (akuadukte), që ishin në mjaft raste realizime të guximshme inxhinierike. Në krahina të ndryshme takojmë disa të tilla që të imponohen me madhësinë, zgjidhjen dhe vertikalishtet e tyre.

Mjaft mirë duket deri në ditët tona urë-kanali i Bëncës në fshatin Bëncë të Tepelenës. Ky objekt është pjesë përbërëse e ujësjellësit që furnizonte me ujë kalanë e Tepelenës. I ndërtuar nga Ali pashë Tepelena në




Fig. 15 Urë-kanali i Bëncës.

fillim të shek. XIX, ky akuadukt në gjendjen e sotme ka arritur me transformime si pasojë e tërmetit që goditi këtë krahinë në vitin 1920. Ka një zgjidhje logjike funksionale dhe bashkë me ujësjellësin e Gjirokastrës është nga realizimet inxhinieriko-hidraulike më interesante të periudhës së Ali pashë Tepelenës. Pjesa mbi lumin e Bëncës e ujësjellësit ngrihet mbi një urë hark guri, që ka harkun kryesor me hapësirë drite 12 m dhe me dy dritare lehtësuese anash këtij. Në pjesën mbi urë ruhet një fragment origjinal i ujësjellësit, i ngritur mbi kolona gur me seksion afër kuadrat, me lartësi sipas pjerrësisë së urës 2-5 m. Këto kolona lidhen në kreun e tyre me harqe guri, mbi të cilat është realizuar ujë-

sjellësi, që fillimisht qe realizuar me tuba qeramike me diametër 11 cm e gjatësi 40 cm. Sot ruhen 6 kolona të fazës së parë me hapësirë 2.8 m midis tyre të lidhura me harqet sipër, të cilat zënë vetëm një pjesë të vogël të gjerësisë së urës nga ana e poshtme, pasi pjesa më e madhe e gjerësisë (1,8 m) (gjerësia totale 3-3,1 m) zihet nga kalldrëmi për kalimin mbi urë.

Pas tërmetit të vitit 1920 u rrëzuan të 15 kolonat mbi tokë, që sot janë të rindërtuara, por pa harqe sipër. Gjatësia e përgjithshme e akuaduktit të Bënçës, që përdorej për ujitje, arrin rreth 110 m. Pasi kalon akuaduktin, rrjedhja vazhdon nëpër vepra arti të ndërtuara në faqen e malit. Rreth 100 m më tej, uji kalon në kanal të mbyllur me gjatësi 8 m. Kanali me seksion 0,3 x 0,5 m në taban shkëmbor, me mure mbajtëse të thata, nga të dy skarpitet në vendet me pjerrësi të madhe, është mbuluar me kapakë guri. Ka edhe vende të pambuluara, sidomos aty ku nuk ka rrezik mbushjeje nga mali. Më në vazhdim, në mal është hapur një tunel me gjerësi 1 m, lartësi 1,8 m dhe gjatësi 10 m




Fig. 16 Ujësjellësi i Gjirrokastër.



Fig. 17 Ujësji në Melan

dhe pas tunelit uji kalon në kanal të hapur krejtësisht shkëmbor me seksion $0,25 \times 0,5$ m. Pra, vërejmë se në këtë objekt kemi të bëjmë me një punë të kualifikuar dhe me një zbatim mjaft praktik të njohurisë së mjeshtrave vendas në veprat e artit konstruktivo-hidraulike, gjë që flet për traditat tona në fushën e artit të ndërtuarit.

Një ujësji mjaft i gjatë, mbi 10 km, dhe mjaft interesant është ai i Kalasë së Gjirokastrës i ndërtuar në kohën e Ali pashë Tepelenës. Burimi i tij është në malin e Sopotit, rreth një orë nga Lazarati. Gjatë rrjetit të ujësjiës takohen 5 ura (akuadukte.) Akuadukti më interesant dhe me vlera monumentale arkitektonike ishte ai që lidhte kalanë me shkëmbin e Qeribashit në lagjen «Dunavat», sot i prishur. Ai qe ndërtuar me dy palë harqe njëri mbi tjetrin, me hapësirë 3,3-4 m ndërjet tyre dhe me lartësi maksimale rreth 15 m. Uji

rridhte në tuba prej qeramike me diametër të brendshëm 11 cm. Diametri i tubave që i ndryshëm. Tubat më të gjerë i gjejmë më afër burimit, gjë që na ka shtyrë të mendojmë se mjeshtrat tanë të ndërtimit e kishin pak a shumë të qartë kuptimin e humbjeve hidraulike në gjatësi dhe kthesa. Llaçi i lidhjes së tubave është mjaft i fortë, ndoshta në të ishte shtuar dhe përmbajtje me të bardhë veze.

Një ujësjellës ruhet dhe në Teqen e Melanit në Gjirokastrë, pranë fshatit Vrraho-Goranxi. Ai merrte ujin nga mali i Buretos me tuba prej qeramike me diametër 11 cm. Furnizonte çezmën e teqes që ruhet edhe sot. Pranë kodrës së teqes, për shkak të një ultësire, ujësjellësi kalon mbi një mur guri me lartësi rreth 3 m e gjatësi afër 60 m, me seksion variabël, që vjen e ngushtohet nga poshtë lart, nga 105 në 83 cm. Në mesin e gjatësisë së murit është hapur një derë me hark guri. Tubacioni kalon në kreun e murit dhe mbu-




Fig. 18 Çezmë e shek. 19

lohet me rrasa guri. Në Dukat të Vlorës ruhet një akuadukt për ujitje ende në funksion, i ndërtuar në vitin 1888, prapa malit të Karaburunit. Ky është ujësjellësi i Ferrunit mbi përroin e Gjinares, ku kalon uji për ujitjen e fushës së Marmiroit. Ky akuadukt është zgjidhur me kanal të hapur mbi tri harqe rrethore. Gjatësia e tij është 21 m; përmasat e kanalit: 1 m gjerësia, 0,5 m thellësia dhe 0,4 trashësia e mureve anësore.

Në fshatin Pacomit të Përmetit ndodhet një çezme me një zgjidhje të goditur të furnizimit me ujë. Ky objekt që është ndërtuar në pjesën e dytë të shekullit XIX, ndodhet pranë rrugës Këlcyrë-Përmet. Këtu çezma furnizohet me ujë nëpërmjet një konstruksioni urë-kanal, që përbëhet nga ura me hark, mbi të cilën kalon ujësjellësi kanal i mbyllur, pasi nën ujësjellës kalon një përrua. Çezma ku del uji është një ndërtim i ri i ditëve tona, që ka zëvendësuar atë të vjetrin. Para daljes së ujit në lëfyt ai depozitohet në muslluk.

Ndërtime interesante hidraulike në vendin tonë janë edhe çezmat e vjetra, të cilat me tiparet e tyre lokale i gjejmë në çdo skaj të vendit, si në Gjirokastër, Krujë, Lezhë, Elbasan, Sarandë etj. Ato ndërtoheshin në rrugë karvanesh apo këmbësorësh, në lagje qyteti apo fshati për t'u shfrytëzuar në mungesë të puseve apo sterave në banesat; ishin monumentale ose të thjeshta. Çezma e pazarit në Elbasan ka një trajtim të veçantë. Ajo përbëhet nga kolona e gurit për nxjerrjen e ujit dhe nga korita masive, një cilindër me mure blloqesh guri lidhur midis tyre me plumb.

Në Dropull ruhen çezma të vjetra, të zgjidhura mjaft mirë teknikisht me të gjithë përbërësit funksionalë, që garantojnë një funksionim normal të çezmës, gjë që tregon për një përvojë të pasur të mjeshtrave tanë në drejtim të ndërtimit të çezmave.

Në fshatin Dhuvjan ruhet një çezmë e tillë me skema të plota funksionale. Uji i burimit përmblihet në depozitën grumbulluese (terezia) rreth 23 m nga çezma. Prej këtej shkon në muslluk-rezervuarin dekantues

para daljes në lëfyt. Në fillim kanali ka qenë me pllaka guri, i mbuluar me seksion katror, sot është me tuba betoni. Veç vrimës së kanalit, nga depozita grumbulluese ka dhe një dalje uji sigurimi që luan rolin e veprës së shkarkimit në rastin e prurjeve të mëdha të burimit. Edhe në musllukun para lëfytit të daljes së ujit, që ka volumin rreth $1,5 \text{ m}^3$ nga ana ballit të çezmës, është hapur një dritare shkarkuese pak mbi nivelin e lëfytit. Në qemer është hapur një dalje për pastrimin e musllukut nga materialet e dekantuar. Nga lëfyti uji derdhet në koritë, një bazen i vogël guri me formë të rregullt gjeometrike, që shfrytëzohet për të pirë ujë kafshët. Në këtë objekt ka dhe vepra të tjera arti. Duke qenë e ndërtuar rrëzë malit e buzë përroit, normal me murin që mbron tubacionin ndërmjet dy depozi-tave, janë ngritur dy prita tërthore me trashësi $0,9$ dhe $1,5 \text{ m}$ e lartësi $1,5 \text{ m}$, për të mbrojtur murin e tubacionit.

Çezma me muslluk e koritë ruhen dhe në krahina të tjera të vendit. Në Delvinë, në lagjen prapa kalasë, ruhet një e tillë me disa dalje uji, e mbuluar me qemere për mbrojtje nga shiu. Një çezmë e tillë karakteristike ruhet afër Manastirit të Goranxisë. Kjo është ndërtuar duke shfrytëzuar guvën e një shkëmbi. Është trajtuar në formë L-je dhe në çdo krah ka dalje uji. Me kanal të hapur uji vjen në musllukun e njërit krah. Krahu tjetër i çezmës ka një muslluk depozite me volum të dobishëm rreth 30 m^3 . Nga pikëpamja arkitektonike faqet e të dy krahëve të çezmave janë trajtuar me harqe të verbra me thellësinë 32 cm nga muri lidhur ndërmjet tyre me pilastër. Çezmat e vjetra të Krujës (krojet), të Saxhes e Ballabanecit nuk kanë ndonjë trajtim të veçantë arkitektonik, por kanë korita guri të punuara në formë govate prej një guri masiv. Lëfytet e daljes së ujit në çezmat e vjetra, si në Krujë, Zagori, në shumë raste janë trajtuar prej guri të gdhendur në formë luge.

Duke u bazuar në këto të dhëna arrijmë në konkluzionin se në vendin tonë ka tradita të pasura në këtë fushë. Mjeshtrit tanë popullorë i kanë zgjidhur drejt problemet teknike e funksionale të veprave hidraulike, duke na lënë kështu një trashëgimi me vlerë në këtë fushë të rëndësishme të artit shqiptar të të ndër-tuarit.

Fatbardha Shkupi

MBËSHTETJE NË ELEMENTIN KOMBËTAR TË ARKITEKTURËS POPULLORE

Shqipëria ka trashëguar nga e kaluara pasuri të rralla veprash ornamentale ku përfshihen skulptura dekorative, arkitrarët me kolona e kapitete, stelat e varreve (gurët), mozaikët, keramoplastika (tullat), afresku, xhami dekorativ, stuk-relievi, drugdhendjet e metali i galvanizuar, të aplikuara në ndërtesa fetare e laike të disa qendrave kryesore të vendit.

Mjeshtrat matjanë, dibranë, çermenikas, mokranë, oparakë, kolonjarë, beratas, gjirokastritë, brez pas brezi i ndërtuan këto vepra të shkëlqyera që nga Danubi deri në Anadoll. Ata e kanë respektuar traditën e lashtë të pararendësve, duke ia përshtatur atë kërkesave estetike-funkionale të arkitekturës së re.

Tek ne ekzistojnë vepra musive (mozaik) nga shek II deri në shek. XIV nëpër termat (banjat), faltoret, dyshemetë e kishave paleokristiane, bizantine dhe mbi murin e bazilikës së Durrësit. Përmendim mozaikun e shekullit VI të fshatit Lin, pranë Pogradecit. Sfondi i dyshemesë është trajtuar me dekoracione gjeometrike dhe litartha që paraqesin motive spirale, të cilat ne sot i gjejmë në gërmimet arkeologjike që nga Kameniku deri në kufi me Austrinë. Më vonë, artistët e drugdhendjes në Jug e në Veri do t'ia përshtasin këto motive dyerve dhe tavaneve, me të cilat do të zbukurojnë faltoret e banesat laike të shekujve XVII-XVIII-XIX.

Në ditët tona mozaiku mbetet përsëri diçka e bukur dhe aktuale. Janë mundësitë që, të bazuar në traditën e vjetër, edhe sot të punohet për aplikimin e mozaikut.

Për këtë qëllim vlejné shkëmbinjtë magmatikë me ngjyra të ndryshme, dierite kuarcore, granite, divinite dhe shkëmbinj gëlqerorë. Në vendin tonë gjenden disa gurore të pasura me elemente dekorative, siç janë p.sh. mermeri i bardhë në Polenë të Korçës, guri i kuq me



Fig. 19 Fragment mozaiku në fshatin Lin.




Fig. 20. Portiku i Durrësit

vija të bardha e të zeza në Muhur të Peshkopisë, shtresat e bardha me vija të zeza në Qafë-Shtambë, mermeri i bardhë i Karaburunit, blloqet e hirta me luhatje të bardha në Tarabosh, shkëmbinjtë qumështorë të Çukës së Sarandës, arenari i vjoltë i Gjirokastrës, ploçat e zverdhura të Beratit, rrasat ngjyrë tokë të qartë në rrethin e Burrelit etj.

Shumë vepra arti të ekspozuara në muzetë e Shkodrës, Durrësit, Gjirokastrës, Beratit e Tiranës janë të përbëra nga ky gur, i cili na paraqitet në trajtë frizesh e kapitelesh që nga shekujt V-IV para erës sonë deri në shekullin XVIII. Mjeshtra të shquar nga fisi i Kurtve, Matajve, Muçajve e Burgajve, gollobordas të ardhur nga Mati kanë daltuar shumicën e faltoreve të fundit të shekullit XVIII e gjatë shekullit XIX në Shqipërinë e Mesme e të Veriut. Të tilla janë p.sh. stemat me mbishkrime të gjetura në pallatin e vezirit të Shkodrës, portiku i Xhamisë së Tiranës, tyrbja e Kap-

llan pashës, portiku i Xhamisë së Peqinit etj. Për ndërtimin e Xhamisë së Ethem beut në Tiranë janë shfrytëzuar guroret e fshatit Shtish-Tufinë. Mjeshtrat e caktuar për ndërtimin e saj nuk filluan punën derisa u sigurua materiali nga guroret e vjetra. Një ndër mjeshtrat e asaj kohe, që jeton akoma, thotë se ky veprim përfshihej në rregulloren e brendshme të ateliesë së ndërtuesve dibranë për ruajtjen e traditës.

Përvoja tregon se në vendin tonë ka gurë të përshatshëm për kompozime artistike, siç janë atributet e profesioneve, të cilat mund të realizohen në mermer ose




Fig. 21 Dekor keramonplastik në Labovë, shek. 13




Fig. 22 Tavani i muzeut të Shkodrës.

arenar, duke shfrytëzuar secili qytet llojin e gurëve që disponohen. Mjeshtrit e lashtë i kanë zbatuar atributet e profesioneve me simbolet në shumicën e veprave të artit ndërtues, si atributi i rrobaqepësit në një shtëpi tiranase, simboli çekiç e hënë i muratorit në një rrugë të Durrësit, relievi i Dionizit në lokalitë e Kafes së Madhe të Shkodrës etj. Ka disa lloje gurësh që ruajnë aftësinë të daltohen duke krijuar skulptura monumen-

tale, friza dekorative e kapitete të shkëlqyera për ndërtesat.

Vendi ynë trashëgon disa ekzemplarë faltoresh me karamoplastikë të zhvilluar, si në Mesopotam, Labovë dhe Voskopojë. Më e bukur është Katedralja e Labovës.

Afresku në vendin tonë ka pasur shtrirje të gjerë. Ne sot ruajmë vepra të këtij lloji që nga shek. XIII në Rubik, në shekujt XIV, XV, XVI në Apoloni e Berat dhe në shek. XVIII në Voskopojë. Piktore të shquar të këtij specialiteti veç Onufri dhe të birit Nikollës kanë qenë vëllezërit Shpataraku e Katro, David Selenicasi etj. Krahas kompozimeve figurale ata kanë realizuar dekoracione në brenditë e fasadat me teknikën afresk, ndër të cilat mjaft interesant është hajati i Kishës së Shën Kollit në Voskopojë. Krahas afreskut u zhvillua piktura murale dekorative, e cila zbukuroi faltoret e shtëpitë tipike që nga fundi i shek. XVIII deri në fillim të shek. XX.




Fig 23 Reliev i betonuar fillimi i shek. 20




Fig. 24 Skalitje druri

Stuk-relievi me allçi është trajtuar pa përjashtim nga të gjithë skulptorët ndër shekuj. Me të janë realizuar kryevepra arti. Edhe artistët shqiptarë e kanë njohur që në lashtësi teknikën e stukut. Në Manastirin e Zvernecit dhe në kishat e Voskopojës ndodhen pjesë ikonostasi të përpunuara me allçi e të bardhë veje, të lyera me ar, të cilat kanë rezistuar deri sot. Në shumë shtëpi shkodrane e lezhjane shohim oxhaqe e tavane në stuk-reliev të bardhë, të cilat janë vepra të mjeshtrave dibranë.

Druri si element ndërtimi njihej edhe nga ilirët. Ata jetuan në shtëpi të drunjta, daltuan stoli e figurina prej kallami e druri. Vepra arti në material druri, më të vjetrat që kemi, janë ikonostaset e Zvernecit dhe të Voskopojës, punuar nga oparakët gjatë shek. XVII, iko-

nostaset e Korçës, Beratit, Gjirokastrës dhe Elbasanit punuar gjatë shekujve XVIII-XIX si dhe shtëpitë e Shkodrës, Tiranës, Elbasanit, Beratit e Gjirokastrës, me çardakë e brendi dekorative të daluara në dru. Gjatë shekullit XIX mjeshtëria e përpunimit të drurit arriti




Fig. 25 Ballkon i një banese shkodrane projektuar nga Kolë Idromeno.

kulmin e përsosurisë, duke u zhvilluar në arkitekturë si element bazë, në karpentari (dograma) për të ndër-tuar çardakë, dyer e musëndra, në daltim, në skalitje e zbukurim tavanesh, trapazanesh, raftesh e arkadash, në traferin për ngrohje ikonostasesh monolite etj. Artistë të shquar të Veriut nga familjet Muça, Teta, Boriçi, Burgu, Haxhiu, Dibra, Xhafa, Sallaku, Miku, Metani, realizuan vepra të rralla në banesat qytetare të Beratit, Elbasanit, Tiranës, Krujës, Shkodrës, Pezës, Gjakovës, Sarajevës e Shkupit. Artistë të shquar të Jugut nga familjet Ftera, Kimi, Lavdari, Lumi, Kalemi, Dukali, Noti, Gjashta, Bashari dekoruan ikonostase e banesa në të gjithë Shqipërinë e Jugut.

Ilirët qenë gjithashtu *metalpunuesit* më të shquar për vegla bronzi e hekuri. Ata përpunuan arin e argjendin, me të cilin krijuan stoli nga më tërheqëset. Në fondet e muzeve janë depozituar thesare të çmuara metali të epokave të ndryshme deri tek shandanët e katedraleve. Gjatë shekullit të kaluar në Shkodër qe krijuar punishtje e derdhjes artistike të metalit, e cila drejtohej nga mjeshtra dibranë, bij të familjes Lleshi, e cila riprodhonte modelimet e piktorit Kolë Idromeno për balaustra e kangjella.

EPIDAMNI DHE DYRRAHU JANË NJË QYTET I VETËM APO DY QYTETE TË NDRYSHME

Lidhur me përcaktimin topografik të qytetit të lashtë të Epidamnit dhe Dyrrahut, deri në ditët tona ka mbetur i pranuar mendimi i shprehur që në shekullin e kaluar nga studiues të huaj se Epidamni dhe Dyrrahu përbënin një qytet të vetëm. Është menduar gjithashtu se ky qytet në fillim quhej Epidamn dhe në kohë më të vona u quajt dhe Dyrrah. Rrënojat e këtij qyteti janë identifikuar me ato që ruhen nën themelet e Durrësit të sotëm.

Studiuesit e parë që u morën me problemet e vësh-tira topografike dhe historike, të cilat lidhen me qytetin e lashtë të Epidamnit dhe Dyrrahut, të bazuar në burimet e autorëve antikë si edhe në materialin arkeologjik që gjetën në vend në kohën e tyre, arritën në përfundimin se Epidamni ishte i vendosur në majën e kodrës së ullinjve të qytetit të Durrësit, kurse Dyrrahu ishte liman në breg të detit, afërsisht në vendin ku sot ndodhet porti i këtij qyteti.

Të nisur nga një vendosje e tillë, mendohej se Epidamni i ndërtuar ashtu si gjithë qytetet e lashta bregdetare, në majë të kodrës, ruajti për një periudhë një ekzistencë të pavarur dhe u bë akropoli i vendit, që kur sistemi i fortifikimit mori një zhvillim edhe më të madh. Mendohej se aty nga fillimi i shek. V para erës-sonë, qyteti i përbërë nga bashkimi i dy vendeve arri-ti kulmin e madhështisë së tij nën emrin Epidamnus, siç quhej nga vendet ku flitej gjuha greke. Thuhet se me emrin Dyrrahkium qyteti ishte më i njohur nga

lundruesit e Adriatikut. Ky ishte emri i shënuar edhe në monedhat e para që janë prerë në kohën e lashtë.

Sipas burimeve historike të shekujve të erës sonë, Epidamnit ja ndryshuan emrin romakët, për arsye se vetë emri Epidamn u dukej se u ndillte të keqen dhe se në gjuhën latine kishte kuptimin e dëmit. Megjithëkëtë grekët vazhduan ta quanin Epidamn, sepse emri i ri binte keq në veshët e tyre dhe nga ana tjetër paralajmëronte stuhi e mbytje. Një burim tjetër thotë se Epidamni mori emrin Dyrrah nga gadishulli mbi të cilin ishte ndërtuar. Këto kanë qenë në vija të përgjithshme argumentet dhe përfundimet e shprehura deri më sot lidhur me qytetin e lashtë të Epidamnit dhe Dyrrahut.

Kërkimet dhe gërmimet arkeologjike që janë bërë në Durrës, këto tridhjetë vjetët e fundit, kanë hedhur më shumë dritë, kryesisht për periudhën e fundit të qytetit të Dyrrahut dhe shumë pak për ekzistencën në të njëjtin truall të qytetit të lashtë të Epidamnit.

Të nisur nga këto rrethana, jemi të mendimit se gështja e përcaktimit topografik të qytetit të Epidamnit në Dyrrah, Durrësin e sotëm, nuk na duket se është plotësisht e dokumentuar. Prandaj edhe mendojmë se duhen bërë përpjekje të tjera në drejtime e rrugë të reja për t'i dhënë këtij problemi një zgjidhje më të argumentuar. Së pari e shohim të nevojshme që të rishikohen edhe një herë, me vëmendje të madhe, të gjitha burimet historike të kohës antike, veçanërisht ato që bëjnë fjalë për ekzistencën e dy qyteteve të veçanta. Këto burime, në shumicën e rasteve, deri më sot ne na duket se janë keqinterpretuar ose nuk janë marrë fare parasysh.

Për këtë qëllim, së pari, do të përmendim burimin që kemi nga Apiani (historian i shek. II të erës sonë), i cili na bën të ditur se «mbreti i këtij vendi, Epidamni, ndërtoi pranë detit një qytet dhe e quajti sipas emrit të tij Epidamn». Nga i njëjti autor mësojmë se «i nipë i mbretit Epidamn, Dyrrahu, të cilin e konsideronin se

rridhte nga Poseidoni, ndërtoi pranë qytetit (Epidamn) një liman dhe i dha emrin e tij Dyrrah».

Ky burim mund të themi se deri më sot thuhet nuk është vlerësuar sa duhet dhe në ndonjë rast thuhet se autori i këtij burimi përmend një varg traditash mitologjike, të cilat akoma nuk janë studiuar me vëmendjen që meritojnë, me gjithë që dihet se të vjetrit nën veshjen e mitologjisë, zakonisht jepnin përcaktimin e saktë të ngjarjeve të kohës së lashtë.

Një autor tjetër, bashkëkohës i Apianit, Pousania thotë se epidamnasit në kohën tonë banojnë në tokën ku banonin që në fillim, por jo edhe në qytetin e vjetër, por në një qytet që ishte larg të parit. Qyteti i sotëm quhet Dyrrah nga emri i themeluesit të tij.

Këto burime kanë një rëndësi të veçantë për vetë faktin se i pari qoftë edhe i veshur nën petkun mitologjik na jep të dhëna mbi ekzistencën e dy qyteteve me emra të veçantë, të cilat janë ndërtuar njeri pas tjetrit në breg të detit Adriatik. Për të dytin është me interes të theksohet se akoma deri në shek. II të erës sonë mbahesh akoma mend se epidamnasit kishin lënë qytetin e tyre dhe banonin në një qytet tjetër pak larg të parit. Në burimet e shkruara të kohës antike qyteti i Epidamnasit për herë të parë përmendet nga historiani i lashtë grek Thuqididi qysh në shek. V para erës sonë. Ky historian na bën të njohur se «Epidamni ishte një qytet që gjendej nga e djathta kur hyn në gjirin e Jonit; pranë tij banojnë barbarët* taulantë, fis ilir. Këtë e kolonizuan korkyrasit.... në shek. VII para erës sonë.»

Në këtë rast kemi një përcaktim topografik shumë të qartë të Epidamnit si edhe burimin e parë që bën fjalë për kolonizimin e qytetit nga kolonë të ardhur nga Korkyra. Duam të përmendim me këtë rast se shumë studiues të ditëve tona, kolonizimin e marrin si themelimin e qytetit të Epidamnit, gjë që është në kun-

*) Grekët e vjetër quanin barbar të gjithë ata popuj që nuk flisnin gjuhën greke.

dërshtim me atë çka na njofton vetë burimi që përmendëm më sipër.

Sipas Thuqididit, Epidamni, në periudhën e parë të lulëzimit të tij (shek. VI-V) para erës sonë, kishte vazhdimisht grindje të brendshme ndërmjet kolonëve të ardhur në këtë qytet, sepse ata ishin të shtresave të ndryshme dhe me prejardhje heterogjene. Siç dihet, këto grindje arritën në një luftë civile, e cila fillimisht zhvillohet ndërmjet epidamnasve, d.m.th. pakicës aristokrate dhe shtresave të tjera. Në këtë konflikt oligarkët, që përfaqësonin aristokracinë, u dëbuan me forcë nga qyteti. Të dëbuarit u ndanë në dy grupe: një pjesë e tyre u kthye në Korkyrë, qytetin-mëmë, kurse të tjerët u vendosën në një vendbanim ilir, në bregdet dhe në afërsi të qytetit.

Këta të fundit, të ndihmuar nga aristokracia e fiseve ilire, e sulmonin vazhdimisht dhe grabitnin qytetin e Epidamnit si nga toka ashtu dhe nga deti. Në një fazë të dytë, lufta civile e Epidamnit i kalon kufijtë territorialë të qytetit dhe protogonistë të vërtetë të saj bëhen qytetet-mëmë të Epidamnit: Korkyra dhe Korinthi.

Korkyrasit, të cilët dolën fitimtarë në këtë luftë, detyruan Epidamnin që në radhë të parë të dëbonte kolonistët e rinj bashkë me garnizonin ushtarak, që Korinthi kishte dërguar në mbrojtje të qytetit, dhe së dyti të pranonin të gjithë të dëbuarit që të riktheheshin në qytet.

Nga ky zhvillim i ngjarjeve, gjatë luftës civile të Epidamnit, sikurse e përshkruan me hollësi Thuqididi, bashkëkohës i kësaj lufte, dalin të qarta disa aspekte të mosmarrëveshjeve serioze që lindën në mes të popullsisë heterogjene të Epidamnit dhe ndërhyrjeve të fiseve ilire, që banonin për rreth qytetit. Kolonët të ardhur nga qytete të ndryshme, përveç kontradiktave ekonomike e shoqërore, ruanin edhe armiqtë e vjetra, të cilat e kishin origjinën në kontradiktat që ekzistonin ndërmjet qyteteve-mëmë, Korkyrës dhe Korinthit.

Rrjedhimisht, është e logjikshme të supozohet se në këto kushte paraqitej shumë e vështirë që të

arrihej mbas luftës një bashkëjetesë paqësore, aq më tepër kur një gjë e tillë kërkohej me imponim nga të tjerë dhe nuk ishte frut i marrëveshjeve të brendshme të arritura ndërmjet palëve të interesuara. Lidhur me këto ngjarje po rikthehemi edhe një herë tek Apiani për të përmendur një paragraf të tij, ku thuhet se..... *pas kësaj, d.m.th. pas luftës civile, korkyrasit i përziën me dyrrahasit kolonët e vet, prandaj limani konsiderohet si helen, kurse emrin e tij korkyrasit e ndryshuan si ugurzi dhe e quajtën qytetin Epidamn, sipas emrit të qytetit të sipërm...* Porse emri i parë fitoi dhe tani quhet si më parë Dyrrah. Sikurse del shumë qartë në këtë pasazh të Apianit, po ta marrim atë tekstualisht shohim se për herë të parë bëhet fjalë për përzierjen e kolonëve korkyras me *dyrrahasit*. Për mendimin tonë, këtu është fjala për ata kolonë që u përzunë nga Epidamni para fillimit të luftës civile, të cilët u strehuan provizorisht në Korkyrë. Mbas përfundimit të kësaj lufte shohim se këta nuk kthehen më në Epidamn por *përzihen me dyrrahasit*.

Bashkimi i këtyre të fundit me *dyrrahasit* nga njëra anë dhe konsiderimi pas kësaj i limanit si koloni helen nga ana tjetër, si edhe ndryshimi nga ana e korkyrasve i emrit të tij nga Dyrrah në Epidamn, lënë shteg për të menduar se oligarkët e dëbuar nga Epidamni, që zunë vend në bregdetin e Ilirisë dhe kur fituan të drejtën për t'u kthyer në Epidamn, duket se nuk luajtën nga vendi, por preferuan të qëndronin përgjithmonë aty ku ishin strehuar si refugjatë.

Sipas këtij burimi, indirekt del se vendbanimi ilir nga ku sulmohej Epidamni ishte limani i Dyrrahut. Mbas këtyre ngjarjeve limani i Dyrrahut arrin të bëhet një qytet me rëndësi të madhe për kohën antike, kurse Epidamni, siç u tha, gjatë gjithë periudhës së gjatë të luftës civile ishte bllokuar si nga deti ashtu edhe nga toka. Në këto rrethana ky qytet përveç dëmeve të mëdha që ai pësonte nga sulmet dhe grabitjet që i bëheshin vazhdimisht si nga kolonët e dëbuar, ashtu edhe nga fiset ilire, nuk mundi të ushtronte

asnjë aktivitet ekonomik e tregtar. Nga ana tjetër, në këtë kohë oligarkët në mërgim i vazhduan marrëdhëniet tregtare si me botën greke ashtu edhe me ilirët, sepse në det ata ishin të mbrojtur dhe të favorizuar nga flota e Korkyrës sikurse ishin edhe në tokë nga fiset ilire.

Në këto rrethana vetëkuptohet se edhe kolonët e dëbuar nga qyteti nuk kishin më ndonjë interes të riktheheshin në një qytet të shkatërruar, ku grindjet ndërmjet popullsisë duket se nuk kishin marrë fund edhe mbas luftës civile.

Sikurse e kanë treguar ngjarjet historike, që u zhvilluan në periudhë të kohëve më të vona, banorët ilirë të limanit të Dyrrahut në bashkëpunim edhe me kolonët helenë që u instaluan këtu mbas luftës civile, ndërtnuan një qytet të ri. Duke qenë në një vend të përshtatshëm dhe në kushte ekonomike e shoqërore shumë më të favorshme nga ato të Epidamnit, Dyrrahu arriti të bëhet një qytet i madh aq sa shumë shpejt e eklipsoi përgjithmonë edhe vetë Epidamnin.

Siç dihet, emri i Dyrrahut si qytet shfaqet për herë të parë në monedhat (tridrakmet) e para autonome që mbajnë legjendën. Këto monedha mendohet se janë prerë ndërmjet viteve 430-350 para erës sonë, d.m.th. pas luftës civile të Epidamnit dhe tregojnë në mënyrë të padiskutueshme se Dyrrahu në këtë kohë është bërë një qytet me rëndësi dhe me një zhvillim ekonomik të pavarur. Një pavarësi të tillë ekonomike, siç dihet, nuk mundi ta arrijë asnjëherë Epidamni megjithëse ai ishte qyteti më i vjetër në bregdetin e Adriatikut.

Për sa i përket faktit se përse Epidamni nuk preu monedha me emrin e tij, ne mendojmë se indirekt shpjegohet me vetë faktin që në periudhën fillestare të qyteteve koloni helene, sikurse shprehet shumë drejtë H. Ceka, kanë qenë në qarkullim, monedha argjendi të Egjines, Athinës dhe Korinthit. Këto monedha përdorëshin vetëm në tregun e brendshëm të këtyre qyteteve si edhe me botën greke, kurse tregtia me fiset ilire bëhej nëpërmjet shkëmbimit të mallrave në natyrë.

Nga sa u tha mësipër mendojmë se ekzistojnë të dhëna që tregojnë për ekzistencën në kohën e lashtë të dy qyteteve ilire të veçanta, Epidamnit dhe Dyrrahut. Për sa i përket përcaktimit topografik të qytetit të Dyrrahut, siç e pamë, ngelet i pranuar mendimi i shprehur se ai ka qenë në vendin ku shtrihet qyteti i Durrësit të sotëm.

Lidhur me përcaktimin e pozicionit topografik ku ka qenë vendosur fillimisht qyteti i Epidamnit, së pari po përmendim Skylaksin, udhëtar dhe gjeograf që ka jetuar në shek. VI-V para erës sonë. Ky autor në veprën e tij «Lundrimi gjatë brigjeve të Evropës, Azisë dhe Afrikës» thotë: «... në fisin e ilirëve është qyteti i Epidamnit dhe pranë tij rrjedh lumi i quajtur Palamni.» Ky burim mendojmë se është me shumë interes për problemin që po trajtojmë. Po të kemi parasysh se përsëkrimi topografik që i bën ky autor qytetit të Apolonisë i përgjigjet plotësisht realitetit atëherë edhe vendosja e Epidamnit pranë lumit Palamn duhet të merret si e vërtetë. Megjithëkëtë ky burim që të bëhet i përdorshëm për qëllimin tonë, duhet që në radhë të parë të bëhet i njohur identifikimi i lumit Palamn. Zgjidhja e këtij problemi vështirësohet edhe për vetë faktin se ky lumë me këtë emër përmendet për herë të parë dhe të fundit vetëm nga Skylaksi.

Ky autor në rastin e Apolonisë na jep më shumë hollësi kur thotë se *lumi Aia del nga mali i Pindit dhe rrjedh anës Apolonisë*. Në këtë mënyrë edhe identifikimi i këtij lumi me Vjosën është i padiskutueshëm, megjithëse ky lumë në burimet antike më të vona, në të shumtën e rasteve përmendet me emrin Aow.

Për sa i takon vetë faktit që Shkumbini në burimet antike më të vona njihet me emrin Genus, Genesis dhe Panysos, mund të supozohet se ky lumë sikurse edhe Vjosa e ka ndryshuar emrin e tij në kohë më të vonë. Ndryshimi i emrit në këtë rast mund të lidhet edhe me ndryshimin e vetë shtratit të rrjedhës së këtij lumi. Dihet se edhe lumenjtë e tjerë (Semani, Vjosa) janë zhvendosur në drejtim të jugut disa kilometra nga gry-

këderdhja e tyre fillestare. Në këtë drejtim janë shprehur edhe mendime se në kohën antike lumi i Shkumbinit derdhej në Adriatik duke përshkuar, në drejtim gjatësor, gjithë fushën e Kavajës. Sipas autorit të këtij mendimi, gjurmët e vjetra të shtratit të këtij lumi kanë qenë të dallueshme deri shumë vonë.

Në qoftë se do të pranojmë në radhë të parë se identifikimi i lumit Palam me lumin e Shkumbinit është i drejtë dhe nga ana tjetër se ky lumë në kohën e lashtë derdhej në det pranë fushës së Kavajës, aty diku afër rrzës së malit të Karpenit, atëherë vendi më i përshtatshëm ku duhet kërkuar qyteti i lashtë i Epidamnit është Kepi i Lagjit në afërsi të Kalasë së Turrës.

Kepi i Lagjit ndodhet rreth 10 milje në jug të qytetit të Durrësit dhe në fillim të gjirit të tij. Ai formohet nga një kodër shkëmbore e vogël me kuotë 90 m, e cila është më e dalë në vargun e kodrave bregdetare të Kavajës. Në anën jugore të kësaj kodre, në grykëderdhjen e një përroi të vogël formohet një gji, i cili megjithëse shumë i vogël, ishte shumë i mbrojtur dhe i përshtatshëm për ankorimin e barkave të kohëve të lashta. Në majën e kodrës së Kepit të Lagjit, që sot mban emrin Kala e Turrës, ruhen aty-këtu gjurmë murësh të ndërtuara me gurë të lidhur me llaç gëlqereje, që tregojnë për ekzistencën në këtë vend, me sa duket, të një kulle vrojtimi, ndërtuar në kohën e mesjetës. Shtojmë se në të gjithë këtë zonë ndeshen me shumicë në sipërfaqe fragmente qeramike, copa tjegullash si dhe fragmente enësh prej balte të periudhave të ndryshme antike.

Prania e materialit arkeologjik në masë të konsiderueshme të lë përshtypjen se e gjithë kjo zonë ka qenë e banuar në kohën e lashtë.

Nga ana toponomastike, emri Epidamnus është konsideruar si emër me origjinë ilire. Lidhur me këtë emër do të thoshim se ai është një emër i përbërë Epidamn-os. Në këtë mënyrë duket qartë se kemi të bëjmë, fillimisht, me një parashtesë greke *opi* që ndër të tjera

ka edhe kuptimin *sipër* ose *mbi*. Në këtë rast emri ilir do të ishte *Damn*, rrënja e emrit grek të përbërë. Kurse os është mbaresa e emrave të gjinisë mashkullore e femërore, të lakimit të dytë në gjuhën greke.

Në qoftë se kjo ndarje do të ishte e pranueshme nga ana gjuhësore, atëherë edhe emri i sotëm i fshatit Domn që gjendet në rrethin e Kavajës dhe shumë afër kalasë së Turrës duhet të konsiderohet si një trashëgimi e emrit fillestar të qytetit ilir në breg të detit Adriatik, që ndërtoi Epidamni, të cilin grekët mbas kolonizimit e quajtën Epidamnos.

Ky toponim që është ruajtur deri në ditët tona në afërsi të vendit ku ne mendojmë se duhet të ishte qyteti i lashtë i Epidamnit ka një rëndësi të veçantë dhe na ndihmon drejtpërdrejt në përcaktimin topografik të këtij qyteti.

Si përfundim, do të thoshim se kjo ishte një përpjekje për ta rishikuar problemin e përcaktimit topografik të qyteteve Epidamn dhe Dyrrah në një kënd vështrimi të ndryshëm nga sa është parë deri tani.

Gjerak Karaiskaj

KALAJA E BOSHANJIT NË RRETHIN E KOLONJES

Kalaja e Boshanjit ndodhet në krahun e djathtë të rrugës automobilistike që të çon nga Korça në Ersekë, mbi një kodër të lartë shkëmbore, në perëndim të fshatit Boshanj.

Kodra është pjesë e një vargu të tërë kodrinor që njihet me emrin «Mali i Zi». Ajo bie me shpate mjaft të pjerrëta nga të gjitha drejtimet me përjashtim të anës lindore, e cila ka një pjerrësi të lehtë. Në rrzëzë të kësaj faqeje shtrihet lugina tektonike e Lubonjës dhe akoma më në lindje kalon rrjedha e sipërme e Osunit. Nga maja e kodrës ku ndodhet dhe kalaja mund të vrojtohet një terren i gjerë, si lugina e Lubonjës, Malësia e Vithkuqit, pllaja e Kolonjës, Kalaja e Hollmit e derisa shikimi ndeshet në vargmalet e Gramozit. Shpatet e kodrës e sidomos pjesa e sipërme e saj janë të veshura me pyje pishash e dushqesh, por megjithatë midis tyre mund të ndiqet traseja e një muri rrethues, i ndërtuar me gurë gëlqerorë të thyer të lidhur në të thatë.

Muri ka një gjerësi prej 2 m, ruhet mesatarisht në lartësinë 1,5 m dhe rrethon një sipërfaqe, e cila ka formën e një trekëndëshi me perimetër 420 m. Në territorin brenda murit rrethues të kalasë, hetohen vende-vende grumbuj gurësh të papunuar pa shenja llaçi, të cilët duhet t'i përkasin rrënojave të banesave.

Nga veriperëndimi kodra e kalasë lidhet me kodrat fqinje me anën e një qafe shumë të lartë dhe dominohet prej tyre. Në këtë mënyrë këtu krijohet pika më delikate nga ku sulmi mund të kryhej më lehtë. Për t'iu shmangur këtij rreziku në këtë vend është ndërtuar

një kullë rrethuese, e vetmja në gjithë fortifikimin. Ajo është ndërtuar me të njëjtën teknikë me atë të murit rrethues.

Kulla ka një diametër të brendshëm prej 4 m dhe gjerësi muresh 2 m. Gjurmët e hyrjes për në kullë, me gjerësi 1,2 m, dallohen nga ana e brendshme e fortifikimit, ndërsa hyrja për në kala, me gjerësi 2,20 m, ndodhet nga Jugu me shpatulla të ruajtura në lartësinë e dy radhë gurësh.

Përveç fortifikimit që zë pjesën më të lartë të kodrës, dallohen edhe gjurmët e dy mureve që zbresin përgjatë shpatit të kodrës deri në rrëzë të saj; njëri nga veriu dhe tjetri nga juglindja, që me sa duket mbylleshin në pjesën fundore. Por këto gjurmë duhen ndjekur me kujdes për të thënë diçka të sigurt.

Muri rrethues i sipërm nuk ndjek një linjë të drejtë, por valëzohet lehtë sipas terrenit. Ai është ndërtuar me gurë të vegjël dhe mesatarë të thyer në përmasa rreth 0,40-0,70 m gjatësi dhe 0,30 m lartësi. Faqja e tyre e rrafshët është vendosur nga ana e jashtme e murit dhe boşllëqet që formohen midis gurëve janë mbushur me kujdes me gurë të vegjël. Shkëmbi nga janë nxjerrë gurët ka pasur karakter shtresor, kështu ata nuk kanë lartësi më të madhe nga 0,30-0,35 m.

Një karakteristikë tjetër e këtij muri është se thellësia e futjes së gurëve e paceteve anësore në brendësi të murit është më e madhe se gjatësia dhe lartësia e tyre. Kjo e bënë murin më të qëndrueshëm, duke e lidhur më mirë me bërthamën e tij të përbërë nga gurë të vegjël dhe mesatarë, të hedhur njëri mbi tjetrin pa ndonjë rregull.

Mbi sipërfaqen e kalasë nuk u gjetën qeramikë ose objekte të tjera arkeologjike të ndonjë periudhe historike. Duke mos pasur të dhëna të tjera ndihmëse do të përpiqemi ta datojmë Kalanë e Boshanjit në bazë të teknikës së ndërtimit dhe të ndonjë elementi arkitektonik.

Teknika me gurë të papunuar, të lidhur në të thatë, është karakteristike kryesisht për periudhën pre-

historike, por në varësi të kushteve social-ekonomike të vendbanimeve, ajo vazhdon në mjaft raste edhe gjatë antikitetit dhe madje deri në kohën e vonë antike (shk. IV-VI).

Në kohën e vonë ndërtimi i një kulle rrethore do të ishte një luks i tepërt për teknikën e përdorur në Boshanj, kur dihet se në një pjesë të madhe të vendbanimeve malore të fortifikuara me mure guri të lidhura me llaç nuk janë përdorur kullat. Nga ana tjetër, as në rrënojat e banesave nuk hetohen gjurmë llaçi ose mure guri të lidhura me baltë. Pra mbetet për t'u shqyrtuar mundësia e datimit të kësaj kalaje në periudhën antike apo prehistorike.

Në vendin tonë, në kohët prehistorike nuk janë përdorur kullat në muret rrethuese të vendbanimeve. Nga ana tjetër, edhe në antikitet kullat rrethore i takojmë në faza më të vona. Në muret e këtij fortifikimi, megjithëse të ndërtuar me gurë të palatuar, vihet re një përdorim i gjerë i veglave prej hekuri për thyerjen e gurëve. Gjithashtu, faqet e jashtme të mureve kanë tendencë për të qenë sa më të rrafshëta dhe boshllëqet midis fugave janë plotësuar me kujdes në mënyrë që këto mure të ishin sa më rezistente kundrejt sulmeve të armiqve. Duke u nisur nga gjithë sa u tha më lart, do të mendonim si kohën më të mundshme të ndërtimit të kësaj kalaje atë të shk. III-II p.e.r., kur kjo zonë ishte nën kërcënimin e vazhdueshëm jo vetëm të mbretërve maqedonas, por edhe të Romës ekspansioniste.

RESTAURIMI I NJË PIKTURE MESJETARE

Kemi parasysh restaurimin e një ikone me format (22 x 32 x 2,5 m) e punuar në dru arre, e marrë nga kisha e shën Kollit në fshatin Boboshticë të rrethit të Korçës.

Duke parë pjesën e përparme të ikonës, vemë re një plasaritje jo të vogël, e cila fillon lart në krahun e majtë të saj dhe përfundon në mesin e panelës e spostuar djathtas. Një e plasur tjetër konstatohet edhe poshtë, në qendër, e cila ngjitet lart deri në 5 cm. Druri ishte i prekur nga insektet, sidomos në qendër. Në të dallohen edhe shenja të zhatjes së fibrës së drurit në qoshen e majtë të ikonës, e cila ka zënë një pjesë të kokës së një figure. Të dëmtuara ishin bordurat veçanërisht pjesa e poshtme, ku ikona ka pësuar djegie dhe më vonë për të mbuluar këtë dëmtim ishte lyer me bojë smalto ngjyrë kafe të hapur.

Grunti është prej gipsi në trashësi afër 1 mm dhe përgjithësisht paraqitet në gjendje të mirë.

Si dëmtim kryesor është ciflosja e pikturës dhe largimi nga baza e tij kryesisht në ato zona ku panela ka pësuar djegie. Ngjyra është në gjendje të mirë, mungon vetëm në ato zona ku është larguar grunti. Verniku mbi pikturë është shumë i hollë, por mendojmë që vajrat mbi të janë më të shumta, që të përziera me lëndë të tjera, si mbeturina dylli, parafine dhe pluhur e paraqesin pikturën të nxirë (me ton të errët), gjë që vështirëson perceptimin e figurave.

Proceset e punës për restaurimin e kësaj ikone ishin: dezinfektimi, konsolidimi i grunit, injektimi, heqja e

vernikut dhe e vajrave të nxira, integrimi dhe vernikosja.

U pa e nevojshme që dezinfektimi të bëhej që në fillim. Pastrimi i panelës në pjesët e djegura të bordurës, të cilat u inçizuan me bisturi në vija vertikale, u bënë për efekt të mbajtjes së gruntit të ri me panelën. Pas këtij pastrimi të imët u bë mbushja e pjesëve të dëmtuara. U mbushën gjithashtu zhvatjet e fibrës dhe ciflosjet e vogla. Kujdes u tregua për nivelimin dhe modelimin e pjesëve të mbushura, sidomos të bordurave me anën e tapës dhe të briskut, për të ruajtur formën e përgjithshme të ikonës.

Pastrimi filloi sipas recepturës së caktuar, d.m.th. dimitil-formamid (1 p) + amilaçital (ip). U punua shumë lehtë duke prekur në fillim sipërfaqe të vogla dhe më pak të rëndësishme. Solucioni bënte efektin e duhur. Nisën të dalin në pah dy figura shenjtorësh, gjë kjo që nuk dihej prej nesh më parë.

Një sfond i artë zë pjesën më të madhe të ikonës (pikturës). Në mes ndodhen figurat elegante të dy shenjtorëve: shën Kozmait, që me një rën dorë mban kutinë e ngjyrave dhe në dorën tjetër paksa të ngritur mban një penel. Ngjitur me të është pikturuar shën Damiani, i cili shoqëron lëvizjen e të parit. Shpërndarja e ngjyrave (e kuqja, bluja, kafja etj.), eleganca e të vizatuarit, teknika e pikturimit, tregojnë se këtë ikonë mund ta ketë pikturuar ndonjë mjeshtër anonim shqiptar.

Çështje me rëndësi estetike ishte për restauruesit pikturimi i atyre pjesëve që u ritokuan. Ngjyrat që u përdorën qenë ato të akuarelit me lidhës të verdhën e vezës dhe një dozë të vogël fenoli. Meqenëse kompozimi ishte vertikal, u pa e arsyeshme që integrimi të punohej me viza po në këtë drejtim, gjë që do të ndihmonte përcaktimin vizual të pikturës. U përdor një ngjyrë okër e artë për sfondin, kafja e errët për plotësimin e pjesës së kokës, e kuqja dhe ngjyra të tjera. Duke e konsideruar të rëndësishëm konturimin anësor të ikonës, bordurat u integruan me ngjyrë të kuqe, e



Fig. 26 Vizatim grafik i pikturës.

cila vlerësoi më tepër pikturën. Tonet që u përdorën ishin më pak se 1/2 e tonit origjinal. Përparësi iu dha harmonizimit të ngjyrave dhe toneve për ruajtjen e unitetit artistik të veprës.

Së fundi u bë vernikosja duke zëvendësuar vernikun origjinal të vetë ikonës me vernik të ri.

Restaurimi i veprave të artit (monumenteve të kultit, ikonave, etj.) është një shkencë relativisht e re, e cila po merr gjithmonë e më tepër rëndësi të veçantë. Vendi ynë është i pasur me shumë monumente kulture të të gjitha gjinive, të cilat për nga vlerat artistike krahasohen me kulturën e vendeve të tjera.

Ndaj në këtë fushë të re detyrat tona janë të mëdha e të rëndësishme.

NJE BANESE KARAKTERISTIKE TRIKULLESHE NË KLOS-KATUND TË MATIT

Në veri të Klosit (qendër e zonës) ndodhet fshati Klos-katund, i cili megjithëse ka një shtrirje relativisht të madhe, ka shumë pak ndërtime. Banesat në këtë fshat janë mjaft të shkëputura nga njëra-tjetra. Shembulli që kemi marrë në studim ndodhet thujse në mes të fshatit, buzë rrugës automobilistike Klos-Bulqizë. Banesa është trikatëshe, e ndërtuar kryesisht prej guri dhe e mbuluar me tjegulla. Ajo është ndërtuar mbi një terren me pjerrësi të vogël, që vjen e lartësohet nga ana lindore, duke zënë në këtë drejtim gjysmën e pamjes të katit përdhes. Nga veriu dhe juglindja ajo paraprihet nga dy oborre të qarkuara me mure rrethuese jo shumë të larta, në të cilat janë ndërtuar portat dyfaqëshe të mbuluara me çati. Banesa është ndërtuar në dy periudha të ndryshme. Pjesa e vjetër e ndërtuar rreth çerekut të parë të shek. XIX, përbën bllokun dykullësh. Muret perimetrale të kësaj pjese janë lidhur organikisht dhe secila nga të dy kullat ka komunikim në vete, gjë që na e përforcon bindjen se pjesa e vjetër që në fillim është ndërtuar për dy vëllezër. Secila nga kullat përbëhet nga tri kthina të vendosura njëra mbi tjetrën. Në katin përdhes futeshin bagëtitë, ndërsa në dy katet e sipërme zhvillohej jeta familjare. Rreth fundit të shek. XIX është ndërtuar kulla e tretë, e cila i është mbështetur pjesës së vjetër nga ana lindore. Nga katërkëndësh, me ndërtimin e ri, zhvillimi planimetrik merr formën e shkronjës L, duke krijuar në këtë mënyrë një lëvizje volumesh që bie më




Fig. 27 Banesa në Klos-Katund.

tepër në sy nga pamja lindore. Në këtë periudhë janë ndërtuar dhe muret rrethuese të përmendura më sipër.

Për të njohur lexuesin me elementet përbërëse do të shqyrtojmë njërën prej kullave, atë të banesës së vjetër, sepse këtu elementet janë të plota e të trajtuara me një përkujdesje të veçantë.

Kati përdhes ka hyrje më vete. Është një kthinë e errët dhe ndriçohet nga një dritare me hapësirë të vogël. Si shtresë ka truallin natyror. Komunikimi për në katin e parë bëhet nga shkallët e jashtme prej druri të vendosura në pamjen veriore. Këtë kat e zë shtëpia e zjarrit, një kthinë kjo e bollshme, me përmasa relativisht të mëdha si në plan dhe në lartësi. Paraprihet nga një korridor i ngushtë, në të cilin janë vendosur shkallët e pjerrëta prej druri, nëpërmjet të cilave shkohet në odën e miqve. Në shtëpinë e zjarrit gatuhet ushqimi dhe flinin njerëzit.

Elementi më i rëndësishëm i kësaj kthine është vatra e madhe e ngritur mbi nivelin e dyshemesë, e mbushur kjo me dhe të ngjeshur. Mbi vatër është ndërtuar tamburi i oxhakut, i cili ka formën e një gjysmë-trungu piramidal me bazë katërkëndëshe. Përmbi zjarr ishte «kamostra», një zinxhir hekuri ku vihehin enët për gatimin e ushqimit. Ndriçimi i kthinës realizohet nga dy dritare të vogla nga ana perëndimore të pajisura brenda me kapakë druri. Në fund të faqes veriore është dera e kthinës sanitare, që është ndërtuar jashtë mureve perimetrale. Në faqet e tjera të kthinës gjenden kamare dhe dollapë muri për vendosjen e enëve dhe ushqimeve.

Në shtëpinë e zjarrit ndenja bëhet në shesh mbi postiqe ose stola të vegjël. Ushqimi shërbehet në sofër druri të rrumbullakët, e cila mbas të ngrënit varej në mur. Në mënyrë të ngjashme me shtëpinë e zjarrit është pajisur dhe oda e miqve, që zë të gjithë katin e dytë. Kjo është kthina më e mirë e banesës. Oda ka dy oxhaqe të ndërtuara përkundrajt njëri-tjetrit në faqet e ngushta të odës, në atë lindore dhe perëndimore. Forma e tyre është e njëjtë me oxhaqet e shtëpisë së zjarrit. Në

faqen lindore, në të dy anët e oxhakut, ndodhen dy dritare të harkuara që i jepnin fillimisht ndriçimin kthinës. Kundrejt shkallëve është ndërtuar dera që të çon në ballkonin e vogël. Dallimi i shtëpisë së zjarrit nga oda e miqve qëndron në trajtimin në këtë të fundit të hapësirës së brendshme.

Një rol të rëndësishëm luan «sergjeni» (qoshku), i cili në kthinën që po përshkruajmë është ndërtuar thujse në mesin e faqes veriore, duke plotësuar nëpërmjet dritareve të tij ndriçimin e saj. Sergjeni i shton odës sipërfaqen e dobishme, ndërsa plastaret e shumta bëjnë të mundur soditjen e natyrës përreth. Ndonëse në odën e miqve elementet përbërëse nuk janë të shumta, vërehet kujdesi për t'i dhënë atyre një formë më të përpunuar. Tamburi i oxhakut qarkohet me një kornizë të profiluar. Po kështu kamaret, dollapët e murit, dritaret e sergjenit kanë elemente druri të përpunuara me mjeshtëri. Në këtë kthinë mbi vatër nuk varet kamostra, por vendoset «demiroxhaku» për mbështetjen e druve. Oda e miqve e kullës tjetër, gjithashtu e pjesës së vjetër të banesës ka thujse të njëjtat elemente përbërëse që përmendëm për odën e miqve të kullës së parë. Por këtu shohim një oxhak në faqen lindore, në të dy anët e të cilit janë kamaret e zakonshme. Në këtë faqe ndodhet dera e ballkonit, e cila është e njëjtë në të gjitha drejtimet me atë që pamë në odën e miqve të kullës së parë. Sergjeni në këtë kthinë është ndërtuar përballë oxhakut në faqen perëndimore. Në vazhdim të tij është vendosur sqolli dhe kthina sanitare. Këtu qoshku zë një sipërfaqe relativisht të madhe që arrin thujse 1/4 e asaj që zë kthina.

Jo pa interes është kompozimi i elementeve në odën e miqve të kullës së re. Në këtë kthinë mungon sergjeni karakteristik, por ai është zëvendësuar nga një ballkon i gjerë i ndërtuar gjatë gjithë gjatësisë së pamjes veriore të kullës. Ai qëndron në raportin 1 : 3 nga ai që zë oda dhe i jep asaj ndriçim nga disa dritare të mëdha të pajisura me kafaz druri dhe kapakë dërrase. Në vazhdim të ballkonit ndodhet korridori, nëpërmjet të cilit

kalohet në kthinën sanitare të ndërtuar në pamjen lindore të kullës së re. Theksojmë se të gjitha kthinat e banesës kanë frëngji për qitje me armë, fakt ky që flet qartë për karakterin mbrojtës të banesës.

Restaurimi i këtij monumenti me vlera të veçanta në gjininë e tij, shtronte para nesh disa probleme lidhur me hartimin e projektit të restaurimit. Problemi më kryesor në këtë restaurim, i cili u krye gjatë viteve 1973-1980 ishte nëse duhej të ruhej ose jo kulla e re, që i ishte bashkangjitur pjesës së vjetër dykullëshe. U pa e arsyeshme që kulla e re të qëndronte, megjithëse qenia e saj e dëmtonte në njëfarë mase pamjen lindore të kullës së vjetër dhe unitetin që kishte pasur ajo fillimisht.

Në radhë të parë, kulla e re tregonte për zhvillimin që ka pasur banesa e Matit në shumë elemente përbërëse të saj, si për shembull: tamburet e oxhaqeve ndërtoheshin me gurë, dritaret merrnin përmasa më të mëdha, muret filluan të ndërtohen me llaç gëlqereje, kulla qarkohej me mure rrethuese. Pamja veriore e kullës së re, që siç e pamë përmbante ballkon, i cili rrethohej me parrmakë druri, ishte vendosur në vazhdim të së vjetrës e krijonte një efekt pozitiv në vlerësimin arkitektonik të saj. Gjithashtu u pa e arsyeshme, duke pasur parasysh qenien e elementeve origjinale dhe përdorimin e banesës, e cila mbas restaurimit do të kthehej në muze, të rindërtohej korridori dhe kthina sanitare e kullës së re. Kështu do të dilte më qartë në pah ana funksionale e katit të tretë të kullës së re, duke rritur gjithashtu vlerën arkitektonike të pamjes veriore që tashti luante rolin e pamjes kryesore të banesës. Zgjatja e bishtave të strehës, sipas elementeve të pakëta që kishin mbetur, bëri që linja e strehës, të rikrijohej me efektin e duhur. Problem tjetër që doli gjatë studimit për restaurimin e banesës ishte dhe zgjatja e ballkonit, i cili duhej të bëhej i bazuar. Gjatë vrojttimeve të bëra në oborrin e shtëpisë rezultoi i ndërtuar një kanal me pllaka guri, në të cilin mblidheshin ujërat nga çatia që mbulonte ballkonin që përmendëm më lart.

Muri rrethues verior u ndërtua për vetë faktin se gjurmët e tij në këtë drejtim nuk mungonin dhe se në kushtet e tanishme ndërtimi i tij ishte i domosdoshëm.

Mbas restaurimit u rrit në mënyrë të ndjeshme vlera arkitektonike e të gjitha pamjeve të banesës, ku shquan në veçanti pamja veriore (kryesore).

KAMERIETE NË BANESËN QYTETARE SHQIPTARE

Në tërësinë e kthinave formuese të banesës qytetare shqiptare, një vend të veçantë zë volumi i kameriesë, i cili është i përhapur kryesisht në banesën gjirokastrite, ndeshet shpesh në Berat dhe mjaft rrallë në Elbasan. Nën këtë emërtim, i cili siç duket rrjedh prej termit «kamara» që në greqishten e vjetër do të thotë qemer, përmbliidhen disa lloje ndërtimesh me funksione të ndryshme. Siç përmendëm, përhapjen më të gjerë kamerietë e kanë në Gjirokastrë. Aty kamerietë kanë forma të ndryshme arkitektonike, të cilat përcaktohen nga funksionet e ndryshme të tyre. Pikërisht duke u nisur nga funksioni, kamerietë e Gjirokastrës mund të ndahen në dy grupe: kamerie me funksione mbrojtëse dhe kamerie pa funksione mbrojtëse. Kamerietë me funksione mbrojtëse janë të veçuara dhe njësh me banesën. Funksioni i tyre është ai i mbrojtjes pasive, duke shërbyer si vend i sigurt ku mbyllet familja dhe plaçkat me vlerë në ndonjë rast rreziku. Qenia e volumit të kameriesë më ulët se vetë banesa, flet qartë për funksionin e mbrojtjes pasive.

Në banesën gjirokastrite kamerietë ndërtohen në ballë, në ndërlidhje me nëndivanin dhe divanin e poshtëm. Duke qenë të dy ambientet e kameriesë mbuluar me qemer, në drejtim të çardakut në katin e dytë krijohet mbi kamerie një lloj tarrace shtruar me pllaka guri e rrethuar me parmakë. Kjo lloj tarrace shërben për qëndrim gjatë stinëve të ngrohta. Krahas kamerieve me funksione mbrojtëse, përhapje shumë të gjerë në Gjirokastrë kanë kamerietë pa funksione mbrojtëse. Këto të



Fig. 29 Gjirokastrër — Pamje e një kamerieje të mbyllur.

fundit kanë një ndërtim që formohet nga sistemi kolonë-hark-qemer, i cili mban një tarracë përbri çardakut. Në këtë rast funksioni i qëndrimit në tarracë mbetet i vetëm për kamerienë.

Kamerietë e veçara me funksione mbrojtëse janë një shfaqje relativisht e rrallë në Gjirokastrër. Në dallim nga kamerietë, njësh me banesën, ato të veçuarat kanë të mbuluar me qemer vetëm një kthinë të vetme, atë përdhese, ndërsa tarraca mbetet e tillë, ose në të sajohet një kthinë banimi.

Kamerietë një me banesën, me ose pa funksione mbrojtëse, në banesën gjirokastrite luajnë rol të rëndësishëm jo vetëm funksional, por edhe arkitektonik. Ndërtuar në pamjen kryesore, ato gjallërojnë mjaft kompozimin, duke krijuar një lidhje të goditur të volumeve anësore të banesës dhe duke i dhënë asaj një hedhje të theksuar në lartësi.

Një përhapje mjaft të gjerë, siç përmendëm, kanë kamerietë dhe në Berat. Ato i ndeshim në të tri lagjet muze: Kala, Mangalem dhe Goricë. Në lagjen «Kala» ruhen disa shembuj kameriësh të mbyllura, të cilat ti-



Fig. 29 Gjirokastër — Pamje e një kamerieje të mbyllur.




Fig. 30 Berat — Kamerate tipike mbi portë.

pologjikisht lidhen me kamerietë me funksione mbrojtëse të Gjirokastrës. Por llojet më të përhapura të kamerieve në qytetin e Beratit janë ato pa funksione mbrojtëse, të cilat ndërtohen pranë banesës, ndërsa në rastet më të shumta mbi portën e jashtme të banesës. Në dy llojet e

këtyre kamerieve, ato kanë qartë funksionin e vendqëndrimit gjatë periudhave të ngrohta. Dhe këto lloje kameriësh formohen nga sistemi i njohur kolonë-hark-qemer. Këto kamerie i gjejmë të ndërtuara dhe në banesat e hapura, duke qenë të lidhura funksionalisht me çardakun.

Kamerietë mbi portat e hyrjes për në oborrin e banesës, funksionalisht nuk kanë dallim nga kamerietë e llojit të parë. Zhvillimi i tyre mbi portat e jashtme është kushtëzuar nga trualli tepër i ngushtë i ndërtimit në lagjet e dendura me ndërtime.

Në qytetin e Elbasanit, në lagjen brenda mureve rrethuese të kalasë, ndeshen pak shembuj kameriësh, si përngjitur banesës ashtu dhe mbi portën e jashtme.

Kamerietë nga ana e trajtimit arkitektonik janë punuar në përgjithësi me përkujdesje të veçantë. Vendi i tyre në kompozim në pjesën më të dukshme të ndërtimit, elemente të tilla si kolona, harku dhe qemeri, kornizat karakteristike prej guri që kurorëzojnë pjesën e sipërme të kameriesë, e bëjnë atë një element tepër të rëndësishëm që i rrit ndijshëm vlerat e banesës.

Lidhur me prejardhjen e këtij elementi, mendojmë se ai në format e para e ka origjinën në banesën me kullë, e cila njihet në rrethin e Gjirokastrës që në shekullin XIV. Zhvillimi në kohë dhe përhapja e gjerë e kamerieve në Gjirokastrë, madje ndërtimi i disa shembujve të thjeshtë edhe në disa fshatra të zonës së Konispolit, të shtojnë të mendosh se Gjirokastra ka qenë dhënëse e këtij ndërtimi dhe për qytetet e Shqipërisë së Mesme. Njëfarë barastrajtimi në arkitekturën e kamerieve të Beratit, gjithashtu mbështet këtë mendim.

**PORTAT E JASHTME NË BANESËN FSHATARE
TË RRETHIT TË PËRMETIT**

Banesat fshatare të rrethit të Përmetit zakonisht qarkohen nga mure guri dhe në to asnjëherë nuk mungon porta e jashtme e hyrjes në oborr. Ajo është trajtuar me mjeshtëri nga gurgdhendësit korçarë dhe kolonjarë që tradicionalisht punonin në këto zona duke ruajtur karakteristikat lokale dhe lidhur me mjedisin ku ato jetojnë. Fryma popullore dhe aftësitë krijuese të këtyre mjeshtrove dhe në këto porta shfaqen me tërë madhështinë dhe forcën e tyre.

Në këto krahina malore, si material ndërtimi për banesat është shfrytëzuar guri i gdhendur. Në të shumtën e rasteve është përdorur guri me tonacione të errëta gri në kafe. Kështu që duhej mjeshtëria e ndërtuesve për të zhdukur monotoninë e këtyre volumeve duke përdorur forma të larmishme dhe daltime me shije të hollë artistike. Janë arritur kështu krijime me vlera arkitektonike.

Portat e jashtme janë elementet e para të banesave, me të cilat kalimtari apo miku i shtëpisë njihet, prandaj edhe ato janë trajtuar me një përkujdesje të veçantë. Zakonisht portat janë të orientuara nga pamja kryesore e banesës, nga ku ato edhe mund të kontrollohen dhe të shfrytëzohen më lehtë nga njerëzit e shtëpisë. Janë gjithmonë të mbuluara me çati katërujëshe me rrasa guri. Dy sofate, karakteristike për ndenjtje gjatë sezoneve të ngrohta, i bënë ato më intime.

Parahyrja është e shtruar me kalldrëm dhe nikoqiret gjithçka e mbajnë pastër.

Portat ndërtoheshin të larta dhe me përmasa të mëdha, gjë që diktohej nga nevoja e kalimit nëpër to e kafshëve të punës shpesh të ngarkuara, që mbaheshin dikur brenda banesës nëpër katoqe. Gjithmonë hapësira e



Fig. 31 Daltime në gurët e paturës.

dritës mbulohet me qemer të dyfishtë për ta siguruar nga ana konstruktive.

Kjo i ka dhënë mundësi mjeshtrit që të kryejë variante jo pa vlerë edhe nga ana dekorative. Harku i poshtëm realizohej prej një, dy apo më shumë gurësh të daltuar me kujdes dhe të palidhur me llaç, por me kunnja hekuri të rrahur, dhe në pjesën e jashtme të trajtuar me shije, duke i dhënë edhe forma të larmishme gjithmonë në shërbim të funksionit. Kyçi në këtë radhë gurësh të harkuar jo rrallë trajtohet ndryshe nga gurët e tjerë. Këta, nga ana e tyre, bartin dekore të pasura me motive floreale, apo gjeometrike, shpesh simbole të stilizuara. Ato në disa raste kanë domethënie fetare, por nuk është lënë pa u gërshetuar në to edhe elementi dekorativ, me karakteristika lokale, që brez pas brezi është trashëguar i pastër. Harku i sipërm formohet gjithmonë nga një rresht gurësh, gjithmonë më të ngushtë dhe më të shumtë në numër se ata që formojnë harkun e poshtëm.

Të dy thembrat e këtyre dy harqeve që formojnë qemerin e portës së hyrjes mbështeten në dy gurë të profiluar pak, të dalë nga plani i shpatullave anësore të paturës, që përveç rolit funksional që luajnë për nga ana e përkujdesjes, të kujtojnë kapitelin. Ndër këto të fundit vendosen gurët e paturës edhe këto me daltime e që shpesh janë të kufizuar në numër. Ata përfundojnë tek një rresht gurësh që formojnë pragun e portës. Në hapësirën e dritës së këtyre portave, që gjithmonë është më e madhe se tek portat e tjera të banesës, vendoset dera dy kanatëshe prej dërrase, e montuar në një kasë druri nëpërmjet hallkash prej hekuri të rrahur, që luajnë rolin e menteshave. Nga të dy kanatet, njëri, ai më pak i përdorshëm, ka të montuar vertikalisht dhe një dërrasë të ngushtë, që luan rolin e ndalesës. Për nga ana e paraqitjes të dy kanatet nuk bien nga niveli i trajtimit të pjesëve të gurta të portës.

Në vartësi të truallit që zotëron banesa, luhat edhe zgjidhja planimetricke e saj. Ajo më e zakonshme është kur dy muret anësore, të një lartësie me ato të avllisë,



Fig. 32 Porta të ndryshme



Fig. 33 Porta të ndryshme



Fig. 34 Porta të ndryshme




Fig. 35 Porta të ndryshme

dalim tej rrafshit të këtyre të fundit, duke marrë një pjesë nga trualli i oborrit.

Rasti dytë është kur muret anësore dalin tej rrafshit të mureve të avllisë, por duke marrë nga rruga, ndërsa rasti i fundit është kur njërin rol të këtij muri e luan vetë banesa, pra njëri mur i saj që sheh në rrugë.

Sigurimi i portës bëhet nga brenda më shpesh nëpërmjet të dy shufrave prej hekuri, që mbërthejnë secilin kanat, por nuk mungojnë raste që të përdoret dhe shuli i portës, që u vete tej e tej të dy kanateve, duke u futur në të dy muret anësore.

Lidhja e këtyre portave me banesën dhe terrenin ku ato ndërtohen, përmasat e goditura nga mjeshtri i bëjnë këto një dukuri me vlera të mëdha në tërë kompleksitetin arkitektonik-urbanistik të fshatit.

Gjerak Karaiskaj Dhimitër Dine

KALAJA E LESHNJËS

Kjo kala ndodhet mbi një kodër shkëmbore në verilindje të fshatit Leshnje (rrethi i Korçës), që njihet me emrin Maja e Manastirishtës. Kodra mbi të cilën është ndërtuar kalaja, paraqet në pjesën e sipërme një kurriz shkëmbor, jo aq të përshtatshëm për një vendbanim të përhershëm se sa për një vendstrehim në raste rreziku. Kjo shpjegon ndoshta dhe mungesën e qeramikës në këtë territor. Në këtë përfundim të çon edhe ekzistenca e një vendbanimi të hapur mbi disa tarraca natyrore në shpatin e një kodre, e cila nuk ndodhet më larg se 300-400 m nga kalaja dhe ka vazhduar të jetojë në bazë të qeramikës të mbledhur mbi sipërfaqe nga periudha e parë e hekurit deri në shek. II p.e.s.

Nga kalaja dominohet lugina që formohet nga rrjedha e sipërme e Osumit, e cila ndodhet në rrëzë të kodrës së kalasë nga ana jugore e saj. Në të dy anët e lumit gjenden parcela të vogla të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, por në përgjithësi vendi rreth e qark është malor, që përcakton edhe karakterin kryesisht blegtoral të vendbanimeve të tij. Nga jugu mund të vrojtohet krejt pllaja e Kolonjës deri në malin e Piqerasit. Nga lindja shikimi ndalet në malin e Gramozit, ndërsa nga veriu mund të shihet Kalaja e Bellovodës, e cila shënon kufirin midis pellgut të Korçës dhe zonës malore të Vithkuqit.

Muret rrethuese të kalasë, që mbronin kurrizin e kodrës, përfshinin një sipërfaqe katërkëndëshe të çrregullt me gjatësi rreth 150 m dhe gjerësi 20-30 m. Muret ru-

hen më mirë nga ana jugperëndimore, ku kapen dhe konturet e një kulle katërkëndëshe, e vetmja që hetohet në këtë fortifikim. Lartësia e mureve tek kulla dhe pranë saj është ruajtur në 1,5 m, por sasia e madhe e materialit të rrëzuar nga këto mure tregon se lartësia e tyre ka qenë mjaft e madhe.

Muret janë ndërtuar në faqen e jashtme me blloqe gurësh të mëdhenj që arrijnë përmasa deri në 1,5 m gjatësi dh 0,60-0,70 m lartësi. Brendësia e murit është mbushur me gurë të thyer në përmasa më të vogla. Gurët e faqeve që janë nxjerrë nga gurorja janë punuar lehtë me çekiç për t'u dhënë forma pak a shumë drejtkëndëshe, ndërsa fugat nuk janë punuar me kujdes, kështu që gurët nuk puthiten mirë midis tyre, duke krijuar kështu zbrazëti të konsiderueshme. Kulla e vetme e kalasë është e ndërtuar në pjesën më pak të mbrojtur të kodrës nga mund të ketë qenë dhe hyrja, që në këtë rast është më pranë vendbanimit të hapur. Kulla ka një gjerësi ballore 8 m. Ajo projektohet prej murit rrethues nga ana lindore 3 m, ndërsa nga perëndimi vazhdon në vijë të drejtë në një gjatësi prej 12 m, ku shihet një kthesë tjetër kënddrejt e murit. Pas kësaj kthese muri vazhdon në linjë të drejtë edhe për disa metra, deri në shpatin e kundërt të kodrës, ku bashkohet me murin rrethues verior. Nga veriu dhe lindja muri mbrojtës mund të ndiqet pa ndërprerje, por në një gjendje mjaft më të rrënuar, ndërsa nga lindja, me përjashtim të kullës dhe një trakti ngjitur me të, mund të kapen vetëm trakte të shkëputura. Faqja e tij e brendshme nuk mund të hetohet në asnjë vend, kështu që nuk mund të matet as gjerësia e mureve. Sidoqoftë, nga gjurmët e ruajtura mund të thuhet se ato kanë qenë mbi 2 m të gjera.

Një problem të veçantë përbën dhe datimi i kësaj kalaje, për të cilin do të mbështetemi kryesisht në teknikën e ndërtimit dhe në disa elemente të tjera të arkitekturës.

Teknika e punimit të gurëve pamje të parë ngjan me atë të ndërtimeve prehistorike. Por forma katërkëndëshe e blloqeve e arritur nëpërmjet një punimi të vrazhdë,

tregon për një shkallë më të përparuar në ndërtimin e mureve të thata. Nga ana tjetër, në këtë fortifikim është e pranishme një kullë drejtkëndëshe si dhe linja të drejta me kthesa drejtkëndëshe të mureve rrethuese.

Lidhja e faqes lindore e kullës me mur rrethues është bërë në një mënyrë të tillë që të kujton fortifikimet antike. Blloqet në forma që i afrojnë katërkëndëshit ndërthuren njëri me tjetrin në vendin e takimit, për të krijuar një lidhje më të mirë të murit me kullën.

Po të niseshim thjesht nga teknika e ndërtimit do ta datonim këtë kala në periudhën kalimtare nga periudha e parë e hekurit në antikitet.

Nga ana tjetër, kulla është një element që mund ta shtyjë këtë datim akoma më tepër në drejtim të antikitetit. Po të kemi parasysh që kalaja e Leshnjës është ndërtuar në një zonë të thellë malore, si dhe faktin që ky fortifikim është përdorur më tepër si një vend strehimi, atëherë mund të mendojmë për një datim edhe më të vonë.

Shembuj ndërtimesh të këtij lloji kemi edhe të tjera në vendin tonë, siç është Kalaja e Xibrit në Mat, e ndërtuar në një zonë të thellë malore, e datuar në shek. IV p.e.r., kulla e Rencit në Shkodër, Kalaja e Boksit po në Shkodër etj. Kjo e fundit ka një formulim të ngjashëm planimetrik me Kalanë e Leshnjës. Ajo ka vetëm një kullë drejtkëndëshe në pjesën më të ngushtë të fortifikimit dhe njëkohësisht më të lehtë për t'u ngjitur, e cila mbronte një hyrje pranë saj. Mund të përmendim edhe muret e periudhës së dytë të Lezhës (Lis II), të cilat qëndrojnë në kohë midis mureve prehistorike të Akropolisit dhe atyre që i përkasin periudhës së dytë të qytetit të Lisusit (fundi shek. IV - shek. III p.e.r.).

Po ta krahasojmë Kalanë e Leshnjës me dy nga fortifikimet më të afërta të saj, d.m.th. me Kalanë e Bellovodës dhe të Boskanjit, do të shohim se midis tyre ka ndryshime. Kalaja e Bellovodës dallon nga muret e saj, të cilat janë me gurë krejtësisht të papunuar në përmasa më të vogla, nga linja e valëzuar e mureve rrethuese si dhe nga mungesa e kullave, tipare karakteris-

tike këto të një fortifikimi të periudhës së parë të hekurit. Ndërsa Kalaja e Boshanjit, megjithëse muret i ka të ndërhuara me gurë të papunuar, dallon prej asaj të Leshnjes nga prania e një kulle të rrumbullakët, e cila tregon për një element që shfaqet vonë në fortifikimet antike.

Në këtë aspekt do të gjenim arsye ta datonim Kalanë e Leshnjes në një periudhë më të vonë nga ajo e Boshanjit. Megjithatë do të ishte e mundshme që këto dy fortifikime të jenë edhe të njëkohshme. Nga sa u tha më sipër do të arrinim në përfundimin se koha më e mundshme e ndërtimit të Kalasë së Leshnjes do të ishte periudha që përfshin shekujt IV-III p.e.sonë.

Si nga pikëpamja morfologjike ashtu edhe nga ajo gjeografike, Kalaja e Leshnjes lidhet më tepër me fortifikimet që shtriheshin përgjatë luginës së sipërme të Osumit në drejtim të pllajës së Kolonjës, se sa me Kalanë e Bellovodës, e cila bën pjesë në sistemin mbrojtës të pellgut të Korçës. Por nga ana tjetër, duke qenë në skaj të fortifikimeve të pllajës së Kolonjës, ajo shënon edhe një pikë kontakti me sistemin mbrojtës të pellgut të Korçës nëpërmjet Bellovodës, e cila e tërhequr disi në brendësi të zonës malore të Vithkuqit dëshmon ndryshe nga shumica e fortifikimeve të pellgut të Korçës, për një karakter të dyfishtë blegtoralo-bujqësor.

BANESA E HASAN TAHSINIT

Në vitin 1979 punonjësit e Institutit të Monumenteve të Kulturës ndërmorën një ekspeditë studimore për të përcaktuar e mbledhur të dhënat e nevojshme për mundësinë e rikonstruksionit të banesës ku ka jetuar Hasan Tahsini me të vëllanë Maliqin, në fshatin Ninat të rrethit të Sarandës. Banesa në fjalë, e cila është djegur nga shovinistët grekë në vitin 1913, ndodhet në skajin lindor të fshatit, pesëdhjetë metra në perëndim të vendit të quajtur Prototi dhe 30 metra në veri të «Kroit Plak». Në afërsi të rrënojave nga veriu ndodhet një man i moçëm.

Me interes qenë të dhënat që u grumbulluan nga gërmimet e pjesshme që u bënë në këtë banesë.

Nga këto të dhëna rezultoi se një rrugicë me gjatësi rreth 25 metra, e shtruar me kalldrëm, e cila ruante pjerrësinë e terrenit dhe ishte pajisur me shkallëzime tërthore në çdo 3-4 metra, lidhte oborrin e banesës me rrugën kryesore të kësaj lagjeje. Vetë banesa ngrihej në një terren të sheshtë, i cili lartësohej prapa saj në anën perëndimore. Pamja kryesore e banesës ka qenë orientuar nga lindja, përpara së cilës ndodhej oborri i shtruar me pllaka guri. Oborri qarkohej me mure rrethuese deri dy metra të larta. Kishte një portë dykanatëshe. Me ndihmën e 4-5 shkallëve dilej në kopsht, i cili ndodhej në anën jugore të saj.

Skema planimetrike e dalë nga të dhënat studimore tregon se banesa ishte e tipit «Divitlie» (tip shumë i përhapur në këtë krahinë), me zhvillim në dy krahë. Ajo ka pasur një gjatësi rreth 14 metra dhe gjerësi rreth 6

metra. Ka qenë dykatëshe, e mbuluar me pllaka guri. Qendrën kompozicionale të katit përdhes e përbënte kato i divanit i shtruar me pllaka (rrasa) guri, nga i cili kalohej në të dy katonjtë e ndodhur anash tij. Për këtë qëllim kanë shërbyer të dy dyert e ndërtuara në të dy faqet veriore dhe jugore të katoit të divanit. Të dy katonjtë ishin të shtruar me pllaka guri (me kalldrëm). Ata kishin ndriçim dhe ajrim të paktë, që përfitohej nga dy dritare të vogla që në rast nevoje shërbenin edhe si frëngji për t'u mbrojtur. Dritaret ishin ndërtuar në të dy katonjtë, në faqen ballore. Katonjtë përdorëshin zakonisht për strehimin e bagëtive dhe mbajtjen e zahireve të dimrit. Në anën veriore të katoit të divanit funksiononin shkallët. Shkalla e gurtë, në pjesën e sipërme të saj, mbështetej mbi një qemer cilindrik, me një hark gjysmërrethor.

Divani kishte dysheme dërrase dhe ashtu si kthinat e tjera ishte i suvatur. Ai kishte ajrim e ndriçim të bollshëm që e merrte nga tri dritare të harkuara, të ndërtuara në faqen ballore. Në stinën e verës divani shërbente për çlodhje.

Dy dyert, të ndërtuara në faqen jugore të divanit, e lidhnin atë me odën e zjarrit dhe magjerinë. Oda e zjarrit zinte pjesën ballore të volumit të dalë të krahut të djathtë të ndërtesës. Kjo kthinë ka pasur dysheme dhe tavan të thjeshtë dërrase. Ajroset dhe ndriçohej nga katër dritare të harkuara nga ana e jashtme, të cilat kanë pasur të njëjtat përmasa me dritaret e divanit dhe të odës së miqve. Dy dritare funksiononin në faqen ballore dhe dy të tjera në anën jugore dhe veriore përballë njëra-tjetrës. Në mes të dy dritareve të ballit ishte oxhaku. Në fund të dhomës ishin ndërtuar dollapë në mur të pajisur me kapakë dërrase. Në vazhdim të odës së zjarrit, e kufizuar nga një çatma, ndodhej magjERIA, ku gatuhej ushqimi. Ajo ishte pa tavan dhe e shtruar me baltë. Balli i magjesisë ishte nga faqja jugore, në të cilën qenë ndërtuar oxhaku dhe dy dritare anash tij, të cilat ishin më të vogla se ato të dhomës së zjarrit dhe odës së miqve.

Në faqen perëndimore ndodhej gryka e furrës, e cila dilte jashtë volumit të banesës. Po në këtë faqe muri

ndodhej edhe një derë që të çonte në kthinën sanitare, edhe kjo e dalë tej rrafshit të jashtëm të muraturës ashtu si edhe furra.

Volumin e krahut të djathtë të banesës e zinte oda e miqve, që ishte edhe kthina më e mirë e saj. Përmasat e saj ishin me gjatësi 8 metra dhe gjerësi 4 metra. Ndrëimi dhe ajrimi realizohej nga katër dritare. Edhe këtu ndodheshin dollapët e murit. Oxhaku ishte i thjeshtë, por i punuar hijshëm. Në pjesën fundore të dhomës ka qenë musëndra, e cila përdorej për të vendosur rrobat e fjetjes. Rreth dhomës kishte rafte ku vendoseshin libra dhe objekte të tjera.

ZHVILLIMI I TEATRIT ANTIK NË ILIRI

Ndërmjet gjurmëve të vendbanimeve të lashta, të cilat populli i quan me emrat qyteza, kala, gradishta etj., një vend të veçantë zënë qytetet ilire, të cilat dallohen për nivelin e lartë ekonomik e kulturor. Kjo nuk është e rastit, por rezultat i zhvillimit të pandërprerë të vendbanimeve sipas kushteve ekonomike dhe shoqërore.

Në qendrat e fortifikuara, sidomos mbas shek. IV p.e.r., u dalluan elemente të reja të jetës urbane. Kon-turet e tyre qartësoheshin gjithnjë e më tepër dhe vihet re një rregullsi në urbanistikën e qyteteve antike. Në radhë të parë i kushtohet kujdes dallimit të zonave të ndryshme në qytet sipas funksionit të tyre. Vend qendror i lihet pjesës ku ndërtohen godinat shoqërore dhe objektet, ku banorët kalonin një pjesë të mirë të jetës. Shumë dëshmi arkeologjike bëjnë fjalë dhe për organizimin e festave të ndryshme, shfaqjeve e argëtiveve, të cilat ishin fillim i traditës teatrale. Ekzistenca e një tradite të tillë lokale, si festat pranverore rituale tek vetë ilirët, na bën të mendojmë se teatri antik në tokën ilire nuk qe thjesht një institucion kulturor i importuar, por pati një bazë vendase.

Forma gjysmërrethore e teatrit u kushtëzua kështu nga karakteri praktik i vendosjes së shkallëve për ta ndjekur shfaqjen të gjithë shikuesit dhe për të zgjidhur problemin e akustikës. Para shkallëve ishte sheshi në formë rrethi ose gjysmërrethi (që është quajtur orkestra) ku luante një pjesë e aktorëve. Skena është pjesa më e dekoruar e teatrit. Ajo është e zbukuruar me kolona

dhe arkitrarë që përmbajnë gdhendje me motive floreale ose gjeometrike. Pjesë të arkitraut me elemente floreale janë zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike në teatrin e Apolonisë. Ky teatër është një nga më të mëdhenjtë e Ilirisë, që filloi të ndërtohet nga fundi i shek. IV p.e.r. Nga llogaritjet e përafërta, duke marrë për bazë diametrin e harkut të poshtëm të shkallëve (24 m), ai duhet të ketë pasur një kapacitet për afër 8000 shikues.

Gjatë shek. III u ndërtuan teatrot në Bylis dhe Nikaja. Ngritja e tyre përkatësisht në dy qytete ilire, që ndodhen 1,5 km larg njëri-tjetrit, është një rast i rrallë dhe një tregues që dëshmon për nivelin e lartë e shkallën e zhvillimit kulturor, që arritën këto dy qytete ilire.

Më i vogli nga këta dy teatro ka qenë ai i Nikaias (Klos, Mallakastër) i llogaritur për 1000 shikues. Shkallarja e tij përbëhej nga 15 rreshta, blloqet e së cilës vendoseshin në gdhendjet e shkallëzuara të shkëmbit. Ndenjëset e radhës së parë, ku uleshin shtresat e parisë së qytetit, janë të pajisura me mbështetëse shpine. Edhe teatri në Bylis (Hekal, Mallakastër) është i pajisur me mbështetëse shpine. Ai ka një skenë më të madhe (10,5 m të gjatë) dhe një numër më të madh ndenjësesh (rreth 30), llogaritur për 5000 shikues.

Në një kohë me këta filluan të ndërtohen edhe teatrot në Orikum dhe Butrint. Teatri i Butrintit shquhet për ndërtimin e përsosur sipas kërkesave të kohës, për konstruksionin e qëndrueshëm që ka bërë të ruhet dhe sot në gjendje mjaft të mirë. Ai është ndërtuar në shpatin jugor të akropolit, i mbështetur pjesërisht në shkëmbin e gdhendur. Dy mure anësore të pajisura me kontraforte dhe një sërë muresh tërthore mbajnë pjesën tjetër të objektit që nuk mbështetet në shkëmb. Këto mure i japin atij një formë planimetricë katërkëndëshe, të pazakontë për teatrot bashkëkohës. Në muret ballore, që mbajnë shkallaret në pjesën e përparme, vijoje dy korridoret e hyrjes. Korridori i majtë ruan një sërë mbishkrimesh, që janë dekrete për lirime skllëvërishe ose dhënie qytetarie. Teatri i Butrintit, megjithëse me përmasa të vogla (19 shkallë me kapacitet rreth 1500 shikues) para-

qet një ndërtim të zgjidhur mjaft mirë në urbanistikën e qendrës së qytetit.

Teatri i Orikumit ruan më shumë gjurmë të shek. I. p.e.r.

Por mund të themi se kjo fazë që ruhet sot i përket një periudhe të dytë ndërtimi. Objekti i vendosur në anën lindore të qytetit, në një terren relativisht të rrafshët, ruan konturet anësore të hyrjes, gdhendjet në shkëmb në trajtë radiale që nuk përkojnë me konturin e teatrit të ndërtuar në shek. I.

Buzë rrugës Aulona - Larisë që kalonte pranë Gjirokastrës së sotme, është ndërtuar një teatër me një formulim krejt të ri në krahasim me ata që përmendëm më lart. Ai është ndërtuar në një terren të sheshtë, mbi një strukturë mbajtëse që në pjesën e jashtme i vishej konturit të shkallëve në formë patkoi. Lartësia e murit mbajtës të jashtëm arrinte rreth 15 m lartësi, 160 m gjatësi; mbështetëj në kontraforte të trasha të punuara dhe këto me llaç-gëlqere, sipas teknikës së njohur romake.

Balli i skenës, i përbërë nga hyrje të mbuluara me harqe rrethore (rreth 5 m të larta) që të çojnë në prapaskenë, është i pajisur përveç kësaj dhe me nike për vendosjen e skulpturave. Kolona të mbështetura në bazamente të larta shërbenin për mbajtjen e dekoracioneve të kornizës mbi hyrjet në formë harku të skenës. Këto elemente ruhen mjaft mirë në skenën e teatrit të Butrintit, i cili përmban mjaft elemente të rikonstrukcionit të shek. II. e. r. që u bënë në këtë objekt.

Rindërtimet e bëra në teatrin antik të Apolonisë, Butrintit, Orikumit në shek. I-III dëshmojnë se teatrot në Iliri janë përdorur deri aty nga shek. IV e.s., kohë në të cilën në të gjithë botën antike ata ndërpresin aktivitetin e tyre.

Krahas zhvillimit të teatrove, në shekujt e parë të erës sonë lindi dhe një formë e re argëtimi: ndeshjet, të cilat zhvilloheshin në një ndërtim të ri, të quajtur amfiteatër.

Amfiteatri (amfi-rreth, the teatros — vend për ndenje) paraqiste disa ndryshime nga teatri, kryesisht në

formulimin planimetrik. Ai ka formën e një elipsi dhe përbëhet nga dy pjesë: nga arena — fusha ku zhvilloheshin ndeshjet e gladiatorëve, dhe nga kaveashkallët për ndëjen e shikuesve.

Ky lloj ndërtimi, lidhur dhe me karakterin e shfaqjeve që zhvilloheshin aty, lindi në periudhën e lulëzimit të sistemit skllavopronar romak, në kohën e thellimit e ashpërsimit të kontradiktave klasore në gjirin e Perandorisë Romake, në përshtatje me kushtet e reja historike dhe të botëkuptimit klasor të shoqërisë së re skllavopronare. Organizimi i këtyre lojërave nga paria e aristokracisë ishte një mjet për të fituar popullaritet dhe për t'i tërhequr vëmendjen popullsisë.

Ndërtim i këtij lloji, i zbuluar deri tani në Iliri, është amfiteatri në Durrës. Zbulimet arkeologjike japin të dhëna se ai filloi të ndërtohet në shek. II. e.r. dhe vazhdoi të funksionojë deri në shek. IV e.r. Megjithëse deri tani është zbuluar vetëm 1/3 e tij, mjaft elemente si shkallaret, galeritë në të cilat kalonin shikuesit për të hyrë në amfiteatër, si dhe galeritë që nxirrnin kafshët në arenë, japin një ide të qartë të formulimit planimetrik të këtij ndërtimi.

Për të zgjeruar sadopak njohuritë për shkallën e kulturës ilire nga shek. III p.e.r., kur filluan të ndërtoheshin këto teatro, dhe deri në shek. IV.e.r., kur këto humbën funksionin e tyre, do të bënim pyetjen: Kush ishin aktorët që jepnin shfaqje në skenat e këtyre teatrove?

Interpretuesit ishin aktorë ilirë, që flisnin gjuhën e tyre që të mund të kuptoheshin nga mijëra shikues ilirë, që mbushnin shkallët e teatrit. Ne nuk dimë me siguri subjektet e dramave të luajtura në teatrot antikë të Ilirisë, përveç faktit me rëndësi që komediografi romak Plauti shkroi një komedi për qytetin Epidamni me titullin «Menehmët». Në këtë komedi ngjarja zhvillohet në Dyrrah dhe trajtohet motivi i ngjashmërisë së plotë të dy personazheve, të cilët mbas shumë peripecish dhe situatave komike njihen se janë vëllezër.

Ndërsa në një komedi tjetër të tij, «Trekacidhëshi», Plauti vë në gojën e një personazhi këto fjalë:

*«Ky fshihet i tëri nën kapelën,
Ilir duket nga paraqitja
Tamam të tillë e ka dhe veshjen».*

Kështu ai thekson edhe diçka tipike të personazheve të komedive të tij.

Me kohë, pushtuesit barbarë i dëmtuan mjaft teatrot antikë. Veprat letrare u injoruan. Ambientet e teatrove u braktisën ose u shembën dhe u përdorën si kavo, nga ku merrej guri për ndërtimin e objekteve të tjera. Gurë dekorativë dhe skulptura u dogjën në furra për të përgatitur gëlqere.

Megjithatë duhet të themi se gjurmët e mbetura nga teatrot antikë, të zbuluar deri sot, paraqesin mjaft interesa për historinë e teatrit.

Organizimi shoqëror pasqyrohet në teatrot antikë, në diferencimin e vendeve për qëndrimin e shikuesve. (Përpunimi me ndenjësë dhe mbështetëse të radhëve të para tregon ndarjen e shoqërisë me klasa).

Prandaj studimi i tyre është i rëndësishëm gjithashtu dhe për sqarimin e disa bazave praktike të kompozimit, për të cilat tashmë ka filluar puna duke u mbështetur në gjurmët e mbetura dhe duke i interpretuar ato shkencërisht.

PASQYRA E LENDES

	Faqe
<i>Emin Riza</i> – Zhvillimi urbanistik i qytetit të Beratit	3-9
<i>Pirro Thoma</i> – Banesa e Gurit të Bardhë	10-17
<i>Stilian Adhami</i> – Një ansambël monumental në Myzeqe	18-24
<i>Dhimitër Kotani</i> – Një monument historik me vlera arkitektonike në rrethin e Tiranës	25-35
<i>Valter Shtylla</i> – Ujësjiellës dhe çezma të vjetra në vendin tonë	36-43
<i>Fatbardha Shkupi</i> – Mbështetje në elementin kombëtar të arkitekturës popullore	44-52
<i>Koço Zheku</i> – Epidamni dhe Dyrrahu janë një qytet i vetëm apo dy qytete të ndryshme?	53-61
<i>Gjerak Karauskaj</i> – Kalaja e Boshanjit në rrethin e Kolonjës	62-64
<i>Skënder Mihalçka</i> – Restaurimi i një pikturë mesjetare	65-68
<i>Leonard Suli</i> – Një banesë karakteristike trikullëshe në Klos-Katund të Matit	69-74
<i>Emin Riza</i> – Kamerietë në banesën qytetare shqiptare	75-79
<i>Faruk Zarshati</i> – Portat e jashtme në banesën fshatare të rrethit të Përmetit	80-85
<i>Gjerak Karauskaj, Dhimitër Dine</i> – Kalaja e Leshnjës	86-89
<i>Veiz Bajo</i> – Banesa e Hasan Tahsinit	90-92
<i>Guri Pani</i> – Zhvillimi i teatrit antik në Iliri	93-97

Tradita ndërtimore në Shqipëri.
[Përgat. nga Inst. i Monumente-
ve të kulturës, Red. J. Toçka],
T., «8 Nëntori», 1981.
98 f.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 930.26(496.5)

T 90

Tirazhi 3000 kopje

Formati 78 x 109/32

Stash: 2204-79

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë, 1981